

Sjellja e politikave për sigurinë kombëtare dhe Gjinia

Peter Albrecht dhe Karen Barnes

Sjellja e politikave për sigurinë kombëtare dhe Gjinia

Peter Albrecht dhe Karen Barnes

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull "Mjet praktik për Gjininë dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë" nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Për Autorët

Peter Albrecht dhe Karen Barnes prej International Alert.

International Alert është një OJQ me seli në Londër e cila ka punuar mbi njëzet vjet që të vendosë themelet për paqe afatgjate dhe siguri në komunitetet e ndikuara nga konflikti me dhunë. Qasje shumë anësh e International Alert-t fokusohet edhe në dhe përgjatë rajoneve të ndryshme; duke dëshiruar që të formojë politikat dhe praktika të cilat ndikojnë mbi ndërtimin e paqes; dhe duke ndihmuar krijimin e shkathtësive dhe kapaciteteve nëpërmjet të trajnimit.

Puna rajonale e International Alert-it është e bazuar në Liqenet e Mëdha të Afrikës, Afrikën Perëndimore, Kaukazin Jugor, Nepal, Shri Lankën, Filipinet dhe Kolumbinë. Projektet tematike të International Alert-it veprojnë në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, duke u fokusuar në çështjet e ndërthurura kritike për ndërtimin e paqes të qëndrueshme. Kjo përfshin edhe biznesin dhe ekonominë, gjininë, qeverisjen, ndihmat, sigurinë dhe drejtësinë.

Botues

Megan Bastick dhe Kristin Valasek, DCAF

Falënderime

Ne do të dëshironim të falënderojmë njerëzit si vijojnë për komentet e tyre të vlefshme për përpilimin e këtij mjeti praktik: Sanam Naraghi Anderlini, Megan Bastick, Willem F. van Eekelen, Ingrid Kraiser, UN-INSTRRAW, Kristin Valasek, Johanna Valenius, Charlotte Watson dhe Mark White. Si shtesë, dëshirojmë të falënderojmë Benjamin Buckland, Anthony Drummond dhe Mugiho Takeshita për ndihmën e tyre gjatë redaktimit, dhe Anja Ebnöther për udhëzimet e saj në projekt.

Mjeti praktik për gjininë dhe RSS

Ky Mjet praktik për Sjelljen e politikave së Sigurisë Kombëtare dhe Gjinisë është pjesë e Mjetit praktik të Gjinisë dhe RSS. I dezhjuar të mundësojë prezantim praktik për çështjet gjinore për praktikuesit dhe vendim-marrësit në reformën në sektorin e sigurimit, Mjeti praktik përfshin si vijon 12 Mjete dhe Praktika që korrespondojnë.

Shënime:

1. Reforma e Sektorit të sigurisë dhe Gjinia
 2. Reforma e policisë dhe Gjinia
 3. Reforma e Mbrojtjes dhe Gjinia
 4. Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia
 5. Reforma Penale dhe Gjinia
 6. Menaxhimi i kufijve dhe Gjinia
 7. Mbikëqyrja parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 8. Sjellja e politikave të Sigurisë Kombëtare dhe Gjinia
 9. Mbikëqyrja e Shoqërisë Civile e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 10. Kompanitë Private ushtarake dhe të Sigurimit dhe Gjinia
 11. Vlerësimi i RSS, Monitorimi dhe Vlerësimi dhe Gjinia
 12. Trajnimi gjinor për Personelin e Sektorit të Sigurimit
- Shtojca për Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare dhe Rajonale

DCAF, OSCE/ODIHR dhe UN-INSTRRAW me kënaqësi falënderojnë për mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jashtme të Norvegjisë për përpilimin e Mjetit praktik. Ne gjithashtu falënderojmë OSCE/ODIHR për mbështetjen dhe prodhimin e këtij Mjeti Praktik.

DCAF

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) promovon qeverisje të mirë dhe reforma në sektorin e sigurisë. Qendra zbaton hulumtime për praktikën e mira, inkurajon zhvillimin e normave përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, bën rekomandime për politikën dhe mundëson këshillime në vend dhe programe për ndihmë. Partnerët e DCAF përfshijnë qeveritë, parlamentet, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e sektorit të sigurimit siç janë policia, drejtësia, agjencitë e zbulimit, shërbimet e sigurimit të kufijve dhe të ushtrisë.

OSCE/ODIHR

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së për dimensionin njerëzor të sigurimit: një koncept i gjerë i cili përfshin mbrojtjen e të drejtave të njeriut; zhvillimin e shoqërive demokratike, me theks të veçantë në zgjidhjet, ndërtimin e institucioneve dhe qeverisjes; përforsimin e sundimit të së drejtës; dhe promovimin e respektit të vërtetë dhe mirëkuptimit të ndërsjellët midis individëve, si edhe midis popujve. ODIHR kontribuoi në zhvillimin e Mjetit praktik.

UN-INSTRRAW

Instituti Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave i Kombeve të Bashkuara (UN-INSTRRAW) është organi i vetëm i Kombeve të Bashkuara që ka mandatin të zhvillojë programe hulumtimi të cilat kontribuojnë fuqizimin e femrave dhe arritjen e barazisë gjinore në tërë rruzullin tokësor.

Nëpërmjet të ndërtimit të aleancave me Shtetet Anëtare të KB, organizatat ndërkombëtare, akademike, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë, UN-INSTRRAW:

- Ndërmerr hulumtime të drejtuara kah veprimi nga perspektiva gjinore që kanë ndikim konkret mbi politikën, programet dhe projektet;
- Krijon sinergji për menaxhimin e njohurive dhe këmbimin e informatave;
- Përforscon kapacitetet e palëve kryesore të interesuara për të integruar perspektivën gjinore në politikën, programet dhe projektet.

Piktura në kopertinë © Keystone, AP, Alvaro Barrientos, 2008.

© DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRRAW, 2008.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. ISBN 978-92-9222-074-7

Citate: Peter Albrecht dhe Karen Barnes. "Sjellja e politikave për sigurinë kombëtare dhe Gjinia". Mjet praktik për Reforma në Sektorin e Gjinisë dhe Sigurisë. Red. Megan Bastick dhe Kristin Valasek. Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRRAW, 2008.

Botuar nga Skenpoint - Skopje

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesat	iii
1. Hyrje.....	1
2. Çka janë politikat kombëtare të sigurisë?	1
2.1 Politika kombëtare e sigurisë	2
2.2 Politika e sigurisë për sektorët specifik	4
3. Pse është gjinia e rëndësishme në sjelljes së politikave e sigurisë?	4
3.1 Pronësia lokale nëpërmjet të proceseve pjesëmarrëse të sjelljes së politikave	5
3.2 Politika gjithëpërfshirëse e sigurisë që i drejtohet nevojave të ndryshme të sigurisë.....	6
3.3 Mos-diskriminimi në politikat e sigurisë dhe institucionet e sektorit të sigurisë	7
4. Si mundet të integrohet gjinia në politikat e sigurisë	7
4.1 Qeveria kombëtare	7
4.2 Parlamenti	10
4.3 Vetëqeverisja lokale	12
4.4 Organizatat e shoqërisë civile	14
4.5 Trajnimi për gjininë	15
4.6 Llogaritja, monitorimi dhe vlerësimi	15
5. Integrimi i gjinisë në politikën kombëtare të sigurisë në kontekst specifik	17
5.1 Shtet e post konfliktit	17
5.2 Shtete në tranzicion dhe në zhvillim.....	19
5.3 Shtetet e zhvilluara	20
6. Rekomandimet kryesore.....	22
7. Resurset shtesë.....	23

SHKURTESAT

ANC	Kongresi Nacional Afrikan
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër femrave
CFSP	Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë
CIA	Agjencia Qendrore e Zbulimit dhe Kundërzbulimit
CIDA	Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar
CPF	Forumet e Policisë në Komunitet
CSO	Organizatrat e shoqërisë civile
DCAF	Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura
DISEC	Komitetet e Sigurisë së Qarkut
DoD	Ministria (Departamenti) e Drejtësisë
ESDP	Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje
FFRP	Forumi i Femrave Parlamentare të Ruandës
GBV	Dhuna e bazuar në gjininë
GSE	Analizat gjinore dhe socio-ekonomike
LCC	Këshillat Lokale të qytetarëve
M&E	Monitorimi dhe vlerësimi
MoD	Ministria e Mbrojtjes
NATO	Pakti i Aleancës së Atlantikut Verior
NGO	Organizatrat Joqeveritare
NSC	Këshilli Kombëtar i Sigurisë
NSCCG	Grupi Koordinues i Këshillit Kombëtar të Sigurisë
NSP	Politika Kombëtare e Sigurisë
NSS	Strategjia Kombëtare e Sigurisë
ONS	Zyra e Sigurisë Kombëtare
PRSP	Dokumenti për Strategjinë e Zvogëlimit të Varfërisë
PROSEC	Komisionet Provinciale të Sigurisë
SAPS	Shërbimi Policor i Afrikës Jugore
SANDF	Forcat Mbrojtëse Kombëtare të Afrikës Jugore
UNIFEM	Fondi zhvillimor për Femrat i Kombeve të Bashkuara
UN SCR 1325	Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për femrat, paqen dhe sigurinë

Sjellja e politikave për sigurinë kombëtare dhe Gjinia

1 Hyrje

Si pjesë e *Mjetit Praktik për Gjininë dhe Reformat në Sektorin e Sigurisë*, ky mjet praktik mundëson një prezantim të përfitimeve dhe mundësive të integritit të çështjeve gjinore në nivelin kombëtar të sjelljes së politikave.¹ Si dokument strategjik, politikat e sigurisë janë thellësisht të rëndësishme në themelimin e përgjigjes së koordinuar ndaj kërcënimeve të sigurisë, dhe mundet të shërbejë si platformë për proceset e reformave të sektorit të sigurisë (RSS). Kjo përfshin politikat e sigurisë kombëtare (NSP) si edhe politikat në sektorët specifik të sigurisë, siç është Libri i bardhë për mbrojtjen. Duke siguruar që çështjet gjinore të jenë të integruara në politikat e sigurisë mundemi të risim pjesëmarrjen dhe pronësinë lokale, dhe të krijojmë politika dhe institucione të cilat kanë më shumë gjasa të mundësojnë siguri efektive dhe të qëndrueshme dhe drejtësi për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat në baza të barabarta.

Ky mjet praktik është i dezenuar të jetë resurs për personelin përgjegjës për iniciimin e proceseve të sjelljes së politikave të sigurisë brenda degëve ekzekutive të qeverisë, përfshirë këtu edhe ata që janë përgjegjës për përpilimin, implementimin dhe vlerësimin e politikave të sigurisë. Si shtesë, mjeti praktik mundet të jetë i leverdishëm për një varg të aktorëve të tjerë të përfshirë në proceset e sjelljes së politikave të sigurisë, përfshirë këtu deputetët e Parlamentit dhe personelin e Parlamentit, personelin e ministrive, organizatat e shoqërisë civile, vetëqeverisjes lokale, organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe shteteve donatorë që mbështesin zhvillimin e politikave të sigurisë.

Më specifik, ky mjet praktik mundëson:

- Prezantim të shkurtër të politikave të sigurisë, përfshirë politikat kombëtare të sigurisë (PKS) dhe politikat e sektorëve specifik;
- Diskutime për rëndësinë dhe përfitimet e aplikimit të perspektivës gjinore për ata që sjellin politikat e sigurisë;
- Veprime praktike për integrimin e dimensionit gjinor në sjelljen e politikave të sigurisë;
- Prezantim të zhvillimit të politikave të sigurisë në shtete post konfliktit, në tranzicion, në zhvillim dhe shtetet e zhvilluara;
- Rekomandimet kryesore;
- Resurset shtesë.

Për çështjet e paqarta për implementimin e politikave nga aktorët specifik të ngërthyer në sektorin e sigurisë ju lutemi referohuni mjeteve të tjera praktike të *Mjeteve Praktike për Gjininë dhe RSS*. Fokusi i këtij mjeti praktik është sjellja e

politikave dhe se si mundet më së miri gjinia të inkorporohet në këta procese. Duhet gjithashtu të përmendet se vetë politika është pak e rëndësishme. Vetëm kur ajo implementohet ajo do të ndikojë në atë se si siguria dhe drejtësia janë të mundësuar në një shtet.

2 Çka janë politikat kombëtare të sigurisë?

Politika e sigurisë në nivel kombëtar përcakton perceptimin e qeverisë për kërcënimet e sigurisë ndaj shtetit dhe popullatës dhe përgjigja e tyre ndaj këtyre kërcënimeve. Politika dallon nga rregullat dhe ligjet. Ligji, për shembull, mund të lejojë ose ndalojë ndonjë sjellje, përdërisa politika vetëm udhëzon për veprimet me të cilat ka më shumë gjasa që të arrihen rezultatet e dëshiruara. Si e tillë, politika përcakton planet e përpiluara për veprimet që të udhëzojnë vendimet nga ana e ekzekutivit. Përpilimi i politikës së sigurimit përfshin përpilimin e qasjes së çështjeve të sigurisë prioritizimin e kërcënimeve të sigurisë dhe sjelljen e vendimeve kryesore lidhur me sektorin e sigurisë.

Politikat e sigurisë në nivel kombëtar, përfshirë politikat e sigurisë kombëtare dhe politikat e institucioneve specifike, ju drejtohen edhe kërcënimeve të brendshme edhe kërcënimeve të jashtme të sigurisë dhe janë të zhvilluara brenda kornizës të legjisllacionit ndërkombëtar dhe rajonal në të cilat shteti është anëtar²

Shumë aktorë të ndryshëm janë të përfshirë në përpilimin e politikave të sigurisë:

- Dega ekzekutive e qeverisë, përfshirë këtu ministrinë e qeverisë, iniciacion proceset e themelimit të politikave të reja të sigurisë ose ndryshimin e politikave ekzistuese. Ekzekutivi emëron anëtarët e organeve të sigurisë dhe të komisioneve për propozimin e politikave.
- Parlamenti mund të aprovojë, propozojë ndryshime ose të refuzojë politikat e sigurisë. Në shumë shtete demokratike, parlamenti gjithashtu ka edhe fjalën e fundit për buxhetin, dhe monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të politikave të sigurisë.
- Vetëqeverisja lokale përfshin qeverinë e shtetit ose qarkut dhe zyrat e kryetarit të komunës. Në bashkëpunim me institucionet lokale të sektorit të sigurisë, ata mund të jenë implementuesit kryesor të politikave të sigurisë në nivel kombëtar.
- Aktorët joqeveritar të sigurisë, siç janë funksionarët e lartë, këshillat e fshatit dhe forcat e armatosura të




Figura 1: Pyetjet që duhet parashtruar kur përpilohen politikat e sigurisë 3

parregullta, janë në shumicën e shteteve post konfliktit dhe në disa shtete në zhvillim zbatuesit kryesor të sigurisë dhe drejtësisë. Prandaj, aktorët e sektorit joqeveritar duhet të përfshihen në proceset e përpilimit dhe implementimit të politikave të sigurisë.

- **Organizatave e shoqërisë civile (CSO)** mund të marrin pjesë në llogaritjen, dezenimi, implementimin dhe vlerësimin e politikave të sigurisë.

Figura 1 tregon procesin që duhet ndjekur dhe pyetjet kryesore që duhet parashtruar gjatë përpilimit të politikave të sigurisë. Mund të adaptohen për të ndihmuar PKS si edhe politikat e sigurisë në sektorët specifik.

2.1 Politika kombëtare e sigurisë

DCAF propozon një definicion më të gjerë të PSK si “një kornizë për përshkrimin se si shteti mundëson sigurinë për shtetin dhe popullatën e saj”.⁴ Ky dokument i politikës mundet gjithashtu të referohet edhe si një plan, vizion, strategji, koncept ose doktrinë. PSK shpesh herë prezantohet edhe si dokument i integruar i cili përcakton se si sektori i sigurisë duhet të strukturohet që ti drejtohet edhe kërcënimeve të jashtme edhe atyre të brendshme të sigurisë. 5 Sepse PSK kërkon që të rrethojë sigurinë kombëtare si një tërësi, ata tentojnë të jetë superior në hierarki mbi sektorët, agjencitë ose të miratojnë politika specifike siç janë ata që ju drejtohen doktrinave ushtarake ose policisë. Shembulli 1 përshkruan procesin e përpilimit të PSK.

Shembulli 1 Zhvillimi i politikës së sigurisë kombëtare (PSK)⁶

1. Të zbatohet **analizë strategjike e ambientit jetësor** dhe të identifikohet “vizioni kombëtar” për shtetin dhe popullatën e tij nëpërmjet të konsultimeve të gjera. Ky proces duhet të ngërthejë konsultimet me Organizatat e shoqërisë civile për të diskutuar brengat e perceptuara dhe brengat e vërteta të sigurisë – p.sh. nëpërmjet të dorëzimeve me shkrim dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në takimet publike.
2. **Analizo dhe prioritzo kërcënimet dhe mundësitë aktuale dhe në të ardhmen** për arritjen e qëllimeve të parashtruara në “vizionin kombëtar”.
3. Përcakto dhe prioritzo kapacitetet kombëtare, edhe në sektorin e sigurisë/drejtësisë edhe përtej tyre, të cilat mund ti drejtohen kërcënimeve të sigurisë dhe të japin shërbime kryesore të sigurisë për qytetarët. Kjo përfshin edhe bazën financiare për implementimin e PSK, si edhe procedurat e përgjithshme të menaxhimit financiar të shtetit në fjalë.
4. **Të ndërmerret një analizë e thellë** për të vlerësuar mundësitë aktuale të institucioneve kombëtare të sigurisë/drejtësisë që mund t’ju drejtohen kërcënimeve dhe të japin shërbime kryesore, krahasuar me kapacitetet e kërkuara. Analiza e thellë duhet, atje ku është e mundur, të bazohet në burimet brenda edhe jashtë institucioneve shtetërore.
5. Të përpilohet **PSK e prioritzuar dhe me buxhet** që të mundësojë siguri dhe drejtësi të përmirësuar në mbështetjen e qëllimeve zhvillimore më të gjera kombëtare.

Shembulli 2 Përmbajtja e strategjisë kombëtare të sigurisë të Lituaniës⁹

Strategjia e sigurisë kombëtare e Lituaniës mundëson një shembull të mirë të çështjeve më të gjera të cilave mund t'ju drejtohet PSK. Mundëson një "vizion kombëtar" për zhvillimin e shtetit, interesave të tij kombëtare dhe veprimeve të kërkuara për të ecur përpara. Me rëndësi është që ajo ngërthen sferën politike, diplomatike, të mbrojtjes, ekonomike si dhe sferat e tjera të politikës shtetërore. "Lituania e percepton sigurinë e saj si mbrojtëse e sovranitetit dhe integritetit territorial të saj, sigurisë së brendshme dhe rendit, themeleve demokratike, stabilitetit ekonomik të të gjitha personave juridik dhe popullatës dhe mbrojtjen e mjedisit të tyre jetësor natyror". Seksionet e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë janë:

- Parashikimet themelore për politikën e sigurisë: ky seksion thekson sistemin ekzistues ndërkombëtar të sigurisë si të leverdishëm, dhe mbrojtjen shumicën e sfidave tradicionale dhe të reja si trans-nacionale në natyrë. Nuk ka kërcënim emergjent ushtarak ndaj sigurisë kombëtare të Lituaniës.
- Interesat e sigurisë së Republikës së Lituaniës: këta janë të ndara në interesa jetike dhe primare. E para përfshin sovranitetin e shtetit, integritetin territorial dhe radhitjen kushtetuese demokratike; respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarë; si dhe paqen dhe prosperitetin e shtetit. Interesat primare përfshijnë stabilitetin global dhe rajonal, lirinë dhe demokracinë në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Shtetet Baltike; duke siguruar furnizime alternative të sigurisë dhe furnizime të resurseve të cilat janë me rëndësi strategjike; si dhe rajon të çliruar nga rreziqet e mjedisit jetësor.
- Sfidat, rreziqet dhe kërcënimet: të përfshira nën këtë kapitull janë terrorizmi, krimi i organizuar, prodhimi i armëve, trafikimi i narkotikëve, migrimi ilegal dhe epidemitë, si edhe varshmëria e Lituaniës në resurset e furnizimit të energjisë vetëm nga një shtet. Kushtet ekonomike, përfshirë këtu edhe mirëqenien e popullatës dhe evitimit të zhvillimit të pabarabartë social dhe ekonomik dhe pavarësisë së shtetit, janë gjithat të pranuar si kërcënimet të mundshme për sigurinë kombëtare.
- Politika e sigurisë së Republikës së Lituaniës: këtu janë përfshirë çaqet dhe qëllimet madhore të sigurisë kombëtare; konceptet strategjike dhe udhëzimet e implementimit; rrethanat të cilat mund të arsyetojnë përdorimin e forcës ushtarake; si edhe rëndësinë e stabilitetit dhe prosperitetit të vendit.
- Veprimet primare dhe mjetet për implementimin e strategjisë: këtu janë përfshirë integrimi në NATO dhe EU, përforcimin e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, pjesëmarrje në operacionet paqësore ndërkombëtare dhe menaxhimin e krizës, etj. Thëks i veçantë i kushtohet rëndësisë për përforcimin e sigurisë të brendshme, ekonomike dhe sociale, kontrollit dhe parandalimit të kriminalitetit, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe kulturor, dhe përforcimit të zbulimit, kundërzbulimit dhe mbrojtjes së informatave të mbrojtura (të fshehta).

PSK dallohen gjithashtu prej politikave të tjera të sigurisë nga spektri i subjekteve të cilëve ata ju drejtohen. PSK ka tentuar të fokusohet në kërcënimet e jashtme të sigurisë të cilat kërkojnë një përgjigje kombëtare. Kjo edhe më tutje vazhdon të jetë rast, për shembull, në **Shtetet e Bashkuara (SHBA)** PSK e SHBA merret me çështjet të cilat shkojnë prej përgatitjes së forcave ushtarake, strategjive nukleare dhe terrorizmit prej armëve kimike dhe biologjike. 7 Gjithsesi, PSK në rritje po përfshin një vlerësim të gjithëmbarshtëm të rrethanave edhe të sigurisë së brendshme edhe ndërkombëtare (shiko Figurën 2). Për shembull, Koncepti i Sigurisë Kombëtare i vitit 1998 të **Bullgarisë** është i bazuar në premisat se nuk ekziston kërcënim i drejtpërdrejtë ushtarak për sigurinë kombëtare. Në vend të saj fokusohet në çështje siç janë krimi i organizuar (trans-nacional dhe tejkuftar), trafikimin (narkotikë, armë dhe qenie njerëzore), kontrabandës

(kryesisht tregtimi i armëve si shkelje e embargos së KB), terrorizmin dhe degradimin e mjedisit.⁸

Një model tjetër është PSK e **Afganistanit** dhe **Azerbajxhanit**, të cilët janë të ndarë në çështjet e sigurisë të jashtme dhe të brendshme. Në rastin e Azerbajxhanit, çështjet e përfshira të jashtme janë integriteti territorial, integrimi me strukturat Evropiane dhe Euro Atlantike, përforcimin e kapaciteteve të mbrojtjes, dhe kështu me radhë. Në të brendshme politika fokusohet në çështjet siç janë përforcimi i demokracisë, mbrojtja e tolerancës kombëtare dhe fetare dhe sigurinë e informatave.

Në **Sierra Leone**, një shtet post konflikti është përgatitur një PSK si vijim i procesit dyvjeçar dhe përpilimit të Pasqyrës së Sektorit të Sigurisë. Pasqyra e re e Sektorit të Sigurisë jep një numër të rekomandimeve, përfshirë

Figura 2: Të kuptuarit e nevojave të jashtme dhe të brendshme të sigurisë¹⁰

Analizat e rrethanave të jashtme dhe të brendshme të sigurisë

Të kuptuarit e nevojave ekzistuese dhe në të ardhmen të sigurisë
Çfarë lloji të dispozitave të sigurisë kërkojnë qytetarët, qeveria, parlamenti dhe të tjerët? Çfarë lloji të sigurisë presin shtete fqinje, shtete në rajon dhe shtetet e tjera? Çka është "siguria kombëtare" ose "siguria për të gjithë qytetarët"?

Të kuptuarit e ndryshimeve
Si ka ndryshuar mjedisi jetësor i shtetit, rajonit dhe ai ndërkombëtar? Si do të duket siguria e mjedisit jetësor në të ardhmen?

Të kuptuarit të kërcënimeve të sigurisë
Prej nga vijnë kërcënimet më të rëndësishme të ardhshme për sigurinë kombëtare? A thua ekziston konsensus kombëtar për perceptimin e kërcënimeve? Nëse jo, si duhet të drejtohem i mungesës së konsensusit? Nëse po, kush ka qenë i konsultuar?

Të kuptuarit e anëve të forta dhe të dobësive
Cilat janë anët e forta dhe dobësitë e livruesve të sigurisë dhe drejtësisë? Cilat janë anët e forta dhe dobësitë e sistemit të kontrollit dhe mekanizmat e mbikëqyrjes?

Shembulli 3 Bosnja dhe Hercegovina dhe Lituania: Përmbajtja e Librit të bardhë

Libri i Bardhë 11 i Mbrojtjes së **Bosnjës dhe Hercegovinës** vendos kujdes të veçantë në reformat e mbrojtjes dhe identifikimin e kërcënimeve kryesore për rrethanat e sigurisë të Bosnjës dhe Hercegovinës (globalisht, në rajon dhe brenda). Më pas ai fokusohet në:

- **Politikën e mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës**, përfshirë parimet strategjike, integrimin në arkitekturën e sigurisë Euro-Atlantike, partneritetin për Paqe? NATO standardizimin dhe ndër-veprimin dhe kontributin për bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore.
- **Sistemi i mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës**, përfshirë kontrollin demokratik të forcave të armatosura, komandës civile, mbikëqyrjes parlamentare, transparencës në planifikimin dhe buxhetimin e mbrojtjes, vargun operativ dhe administrativ të komandës dhe madhësinë e forcave të armatosura.
- **Resurset njerëzore dhe ndërtimi i kapaciteteve**, përfshirë trajnimet individuale dhe kolektive, zhvillimin profesional, angazhimin e forcave të armatosura, operacionet për mbështetjen e paqes, ndihmë dhe mbështetje të operacioneve të zyrtarëve civil, korin e oficerëve, ushtarëve, rezervës dhe sistemet e menaxhimit të personelit.

Politika e Mbrojtjes së **Lituanisë** (Libri i Bardhë)¹² thekson ndryshimin e mjedisit të sigurisë të përgjithshme të shtetit dhe rolet e reja dhe misionet e reja të forcave të armatosura: Më pas fokusohet në:

- **Drejtimet kryesore të politikës së mbrojtjes së Lituanisë**, përfshirë përforcimin e sigurisë Euro-Atlantike, parashikimet e stabilitetit, dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, multilateral dhe bilateral të mbrojtjes.
- **Reformat e mbrojtjes**, përfshirë kalimin nga parime territoriale në parime të mbrojtjes kolektive, detyrat e reja dhe kërkesat për forcat e armatosura të Lituanisë, dhe shqyrtim të strukturës së forcave të armatosura.
- **Menaxhimi i personelit dhe trajnimi**.

nevojën për koordinim më të madh brenda sektorit të sigurisë. Me rëndësi është se nënvizon rreziqet e jo-stabilitetit të brendshëm e jo kërcënimet e jashtme si burim i mundshëm i konfliktit të ripërtërirë.

2.2 Politika e sigurisë të sektorëve specifik

Politikat e sigurisë të sektorëve specifik siç është libri i bardhë i mbrojtjes ose strategjia e sigurisë së shtetit ndryshon nga PSK duke ju drejtuar brengave të sigurisë kombëtare ashtu siç ata lidhen me agjencitë ose çështjet specifike. Si rregull, politika e sektorëve specifik mundëson udhëzim më thelbësor për rolin, strukturën organizative dhe përgjegjësinë e agjencisë, dhe si ajo duhet t'ju drejtohet nevojave të veçanta të sigurisë. Në të njëjtën kohë, politikat e sektorëve specifik duhet që të përcaktohen në harmoni me kontekstin e politikës kombëtare si tërësi, me këtë duke harmonizuar dhe unifikuar politikat qeveritare dhe të organeve të cilat merren me çështjet e lidhura me sigurinë. Prandaj, Si edhe për PSK, politikat e sigurisë të sektorëve specifik janë platforma të rëndësishme prej të cilave fillohen përpjekjet sistematike dhe të koordinuara të RSS.

Politika e sigurisë mund të prezantohet si një “libër i bardhë”, që është faktikisht një emër joformal për dokumentet e parlamentit që artikulojnë politikën qeveritare (shiko Shembulli 3). Ai është një dokument i lëshuar nga qeveria përcaktuar politikën dhe/ose veprimet e propozuara në një sferë të brengës ekzistuese. Edhe pse nuk është e detyrueshme me ligj, libri i bardhë mund të shikohet kohë pas kohe si pjesë e proceseve të hapura këshilluese. Gjithsesi, libri i bardhë përpiket të tregojë qëllimin e qartë nga ana e qeverisë për miratimin e legjislativionit të ri. “Libri i gjelbër” është zakonisht më i hapur dhe mundet pak të propozojë një strategji ose të formulohet si dokument për diskutim ose për konsultim.

3 Pse është e rëndësishme gjinia për sjelljen e politikës së sigurisë?

Gjinia i referohet roleve dhe marrëdhënieve të veçanta, veçorive personale, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave të cilat shoqëria ju përshkruan meshkujve dhe femrave. “Gjinia” prandaj i referohet ndryshimeve të mësuara midis meshkujve dhe femrave, përdërisa “seksi” i referohet dallimeve biologjike midis meshkujve dhe femrave. Rolet e gjinisë ndryshojnë mjaft brenda dhe ndërmjet kulturave, dhe mund të ndryshohen gjatë kohës. Gjinia i referohet jo thjesht femrës ose mashkullit por në marrëdhëniet midis tyre.

Vlerësimi gjinor është proces i vlerësimit të implikimeve për femrat dhe meshkujt ndaj veprimeve të planifikuara, përfshirë legjislativionin, politikat ose programet, në të gjitha sferat dhe në të gjitha nivelet.¹³

Për më shumë informata shikoni Mjetet praktike për RSS dhe Gjinia

Seksioni vijues paraqet një numër të arsyeve se pse gjinia është e rëndësishme në procesin e sjelljes së politikave të sigurisë kombëtare dhe si ajo kontribuon në përforcimin e pronësisë lokale dhe pjesëmarrjes në përmasa të gjera. Në thelb, perspektivat gjinore janë të rëndësishme sepse ata ndihmojnë që të kuptohet që popullata nuk është një grup homogjene, por përmban në vete një spektër të gjerë të nevojave dhe interesave. Duke ditur fakti që sektori i sigurimit ka për detyrë të mbrojë të gjitha grupet brenda popullatës, është imperativ i saj që sjellja e politikave të sigurisë të përfshijë edhe perspektivën gjinore. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e strategjive për aktorët e sektorit të sigurisë të cilët identifikojnë një spektër të gjerë të nevojave – jo vetëm të atyre të komuniteteve më të dukshme dhe më të privileguara ose grupeve demografike në shoqëri.

Shembulli 3 Bosnja dhe Hercegovina Institucionet dhe personeli në sektorin e sigurisë mundet ndonjëherë të jenë burim i pasigurisë, në veçanti për grupet e pa autorizuara në shoqëri. Atje ku politikat janë të verbëta ndaj gjinisë, ata mund në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte të harrojnë dhunën të bazuar në gjininë kundër femrave, meshkujve, djemve dhe vajzave; pabarazinë gjinore dhe praktika të përjashtimit. Vetë kjo kërkon që proceset e sjelljes së politikave të jenë përfshirëse dhe të inkorporojnë perspektivat e të gjitha grupeve në mesin e popullatës së dhënë.

3.1 Pronësia lokale nëpërmjet të proceseve të pjesëmarrjes në sjelljen e politikave

Me qëllim që të krijoj legjitimitet dhe pronësi lokale të politikave të sigurisë në nivel kombëtar, si edhe konsensus për prioritetet e sigurisë, ekziston nevoja që të ketë proces pjesëmarrës për llogaritjen, dezenimi, implementimin dhe monitorimin/vlerësimin e politikës. Proceset pjesëmarrëse gjithashtu zmadhojnë llogaridhënien, transparencën dhe qëndrueshmërinë, tre parimet themelore të RSS. Njëra prej hapave kryesore të sigurimit të sigurisë me pjesëmarrje në proceset e sjelljes së politikave është përfshirja edhe e femrave edhe e meshkujve në vendim-marrje (Shiko Shembulli 4). Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në proceset e politikës së sigurisë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare është në përputhje me

normat dhe instrumentet ndërkombëtare, siç janë Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të KB, dhe e bën strukturën e qeverisjes më përfaqësuese të përbërjes së shoqërisë.

Plotësimi i obligimeve sipas ligjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Integrimi i gjinisë në sjelljen e politikave të sigurisë kombëtare është e nevojshme që të përputhet me ligjet ndërkombëtare dhe rajonale, instrumentet dhe normat lidhur me sigurinë dhe gjininë. Instrumentet kryesore përfshijnë:

- Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër femrave (1979)
- Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Aksion (1995)
- Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për femrat, paqen dhe sigurinë (2000)

Shiko Shtojcën për Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare dhe Rajonale

Në shumicën e shteteve, femrat vazhdojnë të jenë të përjashtuara nga proceset e vendim-marrjes. Për shembull, rindërtimi dhe zmadhimi i sigurisë në Liberi ka kërkuar ristrukturimin e forcave të sigurisë, përfshirë formulimin e PSK dhe politikave të sigurisë për sektorët specifik. Përderisa qeveria e Liberisë vendosi 20% kuota për pjesëmarrjen e femrave në forcat e sigurimit, femrat

Shembulli 4 Përfitimet e sjelljes së politikave të sigurisë me pjesëmarrje në Afrikën Jugore

Procesi i Afrikës Jugore i transformimit post aparteid të politikave të sigurisë dhe institucioneve shpesh herë paraqitet si praktikë e mirë e RSS me pjesëmarrje dhe me pronësi lokale. Për shembull, Pasqyra e proceseve të Mbrojtjes të viteve 1996-1998 përfshinte konsultime kombëtare të cilat siguronin pjesëmarrjen e liderëve fetar dhe të komunitetit, aktivistëve, përfaqësuesve të OJQ-ve dhe të organizatave të femrave. Brenda këtij procesi, organizata me rrënjë të femrave ishin jetike në tërheqjen e vëmendjes për çështjet kryesore të sigurisë siç janë ndikimi i mjedisit jetësor i ushtrisë dhe ngacmimi seksual i femrës. Si përgjigje, u themelua dy nën-komisione në sekretariatit e Mbrojtjes. Më së fundi, natyra pjesëmarrëse në Pasqyrën e Mbrojtjes ishte kredituar me ndihmën e procesit të ndërtimit të konsensusit kombëtar lidhur me çështjet e mbrojtjes dhe gjenerimin e legjitimitetit publik për strukturat e reja të sigurisë.¹⁶

Konsultimet me femrat brenda shoqërisë civile dhe partive politike gjithashtu siguruan që politikat e sigurisë të përgjigjen në gjininë dhe theksuan rolin e femrës si konsumatore dhe livruese e sigurisë. Kjo për shembull, ishte e ilustruar në Librin e Bardhë të Zbulimit të vitit 1994, në Librin e Bardhë të Mbrojtjes për Republikën e Afrikës Jugore të vitit 1996 dhe në Librin e Bardhë për Mbrojtje dhe Siguri të vitit 1998.

Ekspierenca e Afrikës Jugore tregon se përfshirja e femrave dhe përfaqësuesve të organizatave të femrave në debatet lidhur me sigurinë mund të dërgojë deri të zgjerimi i mirëkuptimit për atë se çka duhet përfshirë në politikat dhe deklaratat e sigurisë.

Rezultatet kryesore prej këtij procesi, që kishte ndikim direkt në sjelljen e politikave, përfshijnë:¹⁷

1. Afrika Jugore kaloi shumë tepër reformave të vogla për transformimin e sektorit të sigurisë duke ndërmarrë hapa për konsultimin e popullatës lidhur me rolin e sektorit të sigurisë dhe duke vendosur sigurinë dhe zhvillimin e njerëzve në qendër të kornizës së saj të sigurisë kombëtare.
2. Femrat me shikime dhe vlera të ndryshme dhe të të gjitha racave ishin kryesore në artikullimin e vizionit dhe formimin e proceseve me të cilat siguria e njerëzve u bë prioritet për shtetin.
3. Femrat prej spektrave të ndryshme politike u mobilizuan të përbëjnë 50% të përfaqësimit në negociatat që dërgonin nga zgjedhjet e vitit 1994 dhe 28% të mandateve në Parlament. Ata vazhdojnë të inkurajojnë pjesëmarrjen publike në formimin e politikave dhe mbeten shtylla kryesore e sigurimit të njerëzve.
4. Brenda themelimit të sigurisë, ka rritje të dukshme të njohjes se femrat:
 - a. Sjellin një perspektive kritike për planifikimin dhe implementimin e programeve.
 - b. Kanë ndikim pozitiv si anëtare të forcave të sigurisë.
 - c. janë kritike për ndërtimin e paqes dhe sigurisë.
5. Transformimi i sektorit të sigurisë do të mbetet i paplotësuar nëse kultura institucionale nuk ndërrohet. Tejkalimi i diskriminimit gjinor, siç ishte edhe me diskriminimin racor, është komponenti kryesor dhe tregues i transformimit.

gjithsesi nuk kanë marrë pjesë në proceset e sjelljes së politikave të sigurisë. Konsultimet kombëtare me femrat për të siguruar të dhëna të ndryshme, për shembull, pasiguria sociale dhe ekonomike, dhe për zmadhimin e prospektit të përgjigjes së koordinuar për dhunën e zgjeruar seksual, nuk ishin siguruar.¹⁴ Kjo është në kundërtënie me mendimin ekzistues ndërkombëtar i cili thekson se vetëm me dhënien e të drejtave të barabarta për femrat si meshkujt, dhe qasja deri te proceset e sjelljes së politikave, mundet të zë vend në zhvillimin e qëndrueshëm.¹⁵

Përfshirja e meshkujve dhe femrave në shkallë të barabartë në sjelljen e politikave të sigurisë gjithashtu njofton se ata shumë shpesh kanë nevoja dhe prioritete të ndryshme të sigurisë. Qasjet e ndryshme ndaj dispozitave të sigurisë dhe drejtësisë nevojiten për grupet e ndryshme nëse dëshirojmë të arrijmë qasje të barabartë për të gjithë deri te shërbimet publike. Me rëndësi është se, duke përdorur gjininë si parim udhëzues për zgjerimin e debatit për dispozitat e sigurisë dhe të drejtësisë është çështje jo vetëm e shikimit të nevojave të ndryshme të meshkujve dhe femrave, por gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhet me nevojat specifike të sigurisë të bazuara në aspektin etnik, të klasës, orientimit seksual dhe religjionit.

Një varg i madh i iniciativave mundet të ndërmerret për të siguruar pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të femrave dhe meshkujve, përfshirë këtu:

- Konsultimet në përmasa të gjera me organizatat e bazuara në komunitetet rurale dhe urbane dhe liderët e komuniteteve, përfshirë femrat dhe organizatat e grave.
- Emërimi i femrave në organet kryesore për vendim-marrje të sigurisë në nivel ministror.
- Kërkesat e inkuadruara prej organizatave të grave, komiteteve drejtuese të femrave parlamentare dhe përfaqësuesve të çështjeve të femrave prej ministrive në proceset e sjelljes së politikave të sigurisë.

Me themelimin e proceseve pjesëmarrëse, është siguruar si rezultat udhëzimi për livrimin e shërbimeve efektive. Rezultati është potencialisht një nga efektivitetet më të mëdha operative, përfshirë këtu edhe aftësinë e forcave të sigurisë që t'ju përgjigjen nevojave specifike të sigurisë dhe drejtësisë siç janë të identifikuara në politikën e sigurisë. Si një dokument, politika e kësaj natyre, e zhvilluar nën udhëheqjen e ekzekutivit dhe e shpallur (miratuar) nga Parlamenti, është gjithashtu një instrument efektiv i lobimit që të mbahet udhëheqësia politike përgjegjëse për betimet e dhëna.

Një qasje që i përgjigjet gjinisë dhe pjesëmarrëse ndaj proceseve të sjelljes së politikave të sigurisë me këtë siguron qasje të barabartë për grupet e ndryshme, si për vetë politikën ashtu edhe për proceset me të cilat është zhvilluar, implementuara dhe vlerësuar. Kjo është në veçanti kritike në kontekstin post konfliktit dhe në një numër të shteteve në tranzicion ku arkitektura e sigurisë ka qenë ndërtuar prej mbeturinave si rezultat i rënies së tyre ose i kolapsit gradual.

3.2 Politikë e gjithëmbarshme e sigurisë që ju drejtohet nevojave të ndryshme të sigurisë

Siç u përmend në Seksionin 2, politikën e sigurisë janë në rritje të përpiluara që t'ju drejtohen edhe rreziqeve të jashtme edhe atyre të brendshme të sigurisë. Në vazhde me fokusin e sigurisë njerëzore për plotësimin e nevojave të sigurisë të individëve dhe të komuniteteve, politika e gjithëmbarshme e sigurisë ve në konsiderim nevojat e ndryshme të femrave, meshkujve, djemve dhe vajzave përfshirë këtu edhe kërcënimet e brendshme të sigurisë siç janë ata të bazuara në dhunën mbi gjininë (GBV).

Shiko Mjetet praktike për RSS dhe Gjininë

GBV është ndoshta manifestimi më i dukshëm i nevojave për qasje të ndryshme për livrimin e sigurisë dhe drejtësisë. Ky është një fenomen global, q prek femrat dhe vajzat, si edhe meshkujt dhe djemtë. Në bazë të statistikës, UNIFEM vlerëson se një prej çdo tre femra në rruzullin tokësor do të jetë subjekt i ndonjë forme të GBV, siç është sulmimi, dhunimi, trafikimi ose rrahja. 18 Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve dhe Parandalimeve deklaroi se secilin vit në SHBA 1.500.000 femra dhe më shumë se 800.000 meshkuj dhunohen ose në aspektin psikik keqtrajtohen nga partnerët intim.¹⁹ Në Xhamajkë, Strategjia Kombëtare e Sigurisë pranon që dhuna familjare kontribuon në modelin e përgjithshëm të krimit dhe dhunës, si rezultat i efekteve të tyre të molitura në fabrikën sociale dhe rolin të saj në socializmin e rinisë që të përdorin dhunën si mjet për zgjedhjen e konflikteve. 20 Implikimi financiar i GBV është gjithashtu thelbësor, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin e shërbimeve të livruara si edhe në sektorët e tjerë të shtetit. Sipas Zyrës Kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar (UK), dhuna familjare është shkaku kryesor i vdekjes së femrave të moshës 19-44 vjeç, që MB e kushton £23 miliardë në

Shembulli 5 Dhuna e bazuar në gjini shkaktuar nga forcat e sigurisë në Sierra Leone²²

Konflikti dhjetë vjeçar në Sierra Leone u shpall si i përfunduar në janar të vitit 2002. Forcat e armatosura dhe policia kryen dhunë seksuale gjatë konfliktit, dhe meshkujt mbetën të tej përfaqësuar në që të dy institucionet, që kufizonte përpjekjet për reforma në vazhde të linjave më të përshatshme për gjininë. Kultura ushtarake në mesin e forcave të sigurisë mundet të keqësohet dhe të institucionalizohet GBV në gradat ushtarake dhe dosjet e forcave të armatosura dhe të policisë.

Si përgjigje, çështjet e të drejtave të njeriut janë integruar në trajnimet e ofruara për forcat e sigurisë të zbatuara nga Ekipi Britanik Ndërkombëtar për Këshillime Ushtarake dhe Trajnime, si edhe për policinë e Sierra Leone-s (të iniciuar nga Projekti për Mbrojtjen dhe Sigurinë të Komunitetit të Komonuelthit). Trajnimi, kodi i sjelljes, zbatimi i masave disiplinore, përpilimi i protokolleve dhe mekanizmave institucionale për tu marrë me ankesat për GBV, dhe rritja e përfaqësimit të femrave mund të ndihmon për t'ju drejtuar GBV brenda forcave të sektorit të sigurisë.

vit. ²¹Çështjet e gjinisë, në veçanti GBV, shumë shpesh barazohen me femrat dhe vajzat. Gjithsesi, çështjet gjinore kanë rëndësi të barabartë edhe për meshkujt dhe djemtë, dhe duke pasur në konsiderim nevojat e tyre të veçanta të sigurisë në proceset e sjelljes së politikave siguron një qasje të gjithëmbarshme. Për shembull, dhuna seksuale kundër meshkujve brenda forcave të armatosura dhe burgjeve është një tabu i madh, por një çështje që meriton vëmendje. Një studim për burgjet në katis shtete në SHBA rezultoi se afërsisht një mashkull në çdo pesë prej tyre ka raportuar seks të detyruar ose me dhunë përdërisa ka qenë i burgosur. ²³ GBV kundër meshkujve dhe djemve është gjithashtu një çështje gjatë konflikteve, ku ata janë subjekt i dhunës seksuale, masakrave në bazë të zgjidhjes së gjinisë dhe rekrutimit të detyrueshëm. Përballë kësaj përhapjeje, GBV programet që targetojnë meshkujt dhe djemtë që kanë mbijetuar janë pothuajse jo-ekzistuese në kontekstin e post konfliktit. ²⁴

Duke pasur në konsiderim përhapjen e madhe dhe implikimin e rëndë social dhe financiar të GBV, kjo është çështje e sigurisë që duhet të merr vëmendje edhe në politikat e sigurisë kombëtare – si ë PSK dhe sektor ose në çështjet e politikave specifike.

3.3 Jo-diskriminimi në politikat e sigurisë dhe institucionet e sektorit të sigurisë

Reduktimi i diskriminimit nga personeli i sektorit të sigurisë në baza të religjionit, gjinisë, racës, orientimit seksual ose bazë të tjera joadekuate mundet të ndërtojë besim, të rritë legjitimitetin dhe përmirësojë dispozitat e sigurisë dhe drejtësisë. Si një dokument strategjik, politika e sigurimit përbeton qeverinë që t'ju drejtohet çështjeve të sigurisë dhe drejtësisë, edhe në sferën publike si edhe brenda kategorisë dhe dosjeve të vetë forcave të armatosura.

Si e tillë, politika e sigurisë mund të themelojë rregulla mbrojtëse kundër diskriminimit brenda institucioneve të sektorit të sigurisë. Sjellja e politikave të sigurisë në bazë të barazisë gjinore ndihmon që të sigurohet që politikat mos përmbajnë fjalë të cilat shkaktojnë diskriminim. Por, gjithashtu, më përfshirjen e deklaratave specifike për çështjen e mos-diskriminimit, politikat e sigurisë mundet të kenë ndikim pozitiv mbi strukturën dhe personelin e forcave të armatosura, policisë, shërbimeve të zbulimit dhe institucioneve të tjera të sektorit të sigurisë.

4 Si mundet të integrohet gjinia në politikat e sigurisë?

Ky seksion mundëson shembuj dhe sugjerime për atë se si të sigurojmë që proceset e sjelljes së politikave të sigurisë të përfshijnë çështjet gjinore. Pasi që zhvillimi i politikave të sigurisë pa ndryshim është i ndryshëm në

secilin kontekst, do të ekzistojnë sfida dhe mundësi të ndryshme për integrimin e çështjeve gjinore. Si vijon sugjeron se duhet të adoptohen në kontekst lokal. Për debat lidhur me sjelljen e politikave të sigurisë në kontekst të veçantë, shiko Seksionin 5. Ky seksion është strukturuar nga institucionet e ndryshme të angazhuara në përpilimin e politikave të sigurisë: qeveria kombëtare (përfshirë organet e koordinimit të sigurisë dhe komisionet për propozimin e politikave), parlamenti, vetëqeverisja lokale dhe CSO. Ai gjithashtu përfshin dy çështje të ndërsjella që duhet të adresohen brenda institucioneve të ndryshme: trajnimi gjinore dhe monitorimi dhe vlerësimi.

Siç u theksua më parë, zhvillimi ose revidimi i politikës kombëtare të sigurisë kërkon informata prej një spektri të gjerë të pjesëmarrësve, përfshirë livruesit e sigurisë të jashtme dhe të brendshme. Përpilimi i një politike efektive të sigurisë prandaj kërkon shumë resurse, si nga aspekti njerëzor ashtu edhe financiar. Për këtë arsye, politikat kombëtare të sigurisë mundet jo aq shpesh të hapen për rishqyrtim, diskutim dhe konsultime në bazë të gjerë. Prandaj është jetike që kur jepet mundësia për një politike të freskët, të jetë kryer puna rrënjësore që të sigurojë që janë përfshirë çështjet gjinore.

4.1 Qeveria kombëtare

Nevojitet përbetimi i politikës ekzekutive që të iniciojë përpilimin ose modifikimin e politikës së sigurisë. Për shembull, ministri i mbrojtjes zakonisht do të anashkalojë realizimin e politikës së improvizuar të mbrojtjes. Prandaj, përbetimi për një proces përfshirës të krijimit të politikave të sigurisë dhe adresimi i çështjeve të gjinisë duhet të ndërthet në nivelet më të larta të qeverisë dhe midis personelit të lartë ministror, për të siguruar proces dhe rezultate gjë e përgjigjen çështjes gjinore.

Në rastin e PSJ të Kanadasë NSP ²⁵ përpilimi rruhej fortë në duart e Zyrës së Këshillit të Fshehtë. Kryeministri vendosi që procesi i formulimit nuk duhet të jetë midis departamenteve sepse besohej se kjo do të vononte procesin e përpilimit. Aktorët edhe brenda edhe jashtë qeverisë, përfshira ata me ekspertizë gjinore, me këtë ishin të përjashtuar. Përfshirja e perspektivave të ndryshme për atë se çka domethënë siguria kërkon kohë, por është e nevojshme që të prodhojë politika të forta dhe të ndërthyer të sigurisë. Nëse vendosen politika përjashtuese të sigurisë, kjo do ta ngushtojë transparencën, mbikëqyrjen demokratike dhe pikat hyrëse që ju drejtohen çështjeve gjinore.

Mund të ndërmerren një numër i hapave, ose nga personeli i ministrave, parlamenti ose CSO, për ndërtimin e kapaciteteve gjinore dhe përbetimin në nivel të lartë qeveritar dhe personel të përfshirë në sjelljen e politikave të sigurisë:

- Ngritja e vetëdijes midis udhëheqësve shtetëror, ministrave, personelit të lartë ministror dhe personelit kryesor në institucionet e sektorit të sigurisë për përbetimet ndërkombëtare dhe kombëtare për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut.
- _ Të mbahen informime të shkurtra dhe raportime për funksionarët e lartë për çështjet e politikave, livrimin të

zmadhuar të shërbimeve dhe efektivitetit operativ për aplikimin e qasjeve në sjelljen e politikave.

- Shënime gojore të përgatitjes për çështjet lidhur me sigurinë për personelin e nivelit të lartë, që në mënyrë përkatëse t'ju drejtohen çështjeve gjinore.
- Mundësojnë shënime prej informimeve të shkurtra për funksionarët e lartë duke demonstruar ku mund të përfshihen çështjet gjinore në politikat e sigurisë, dhe të kontribuojnë në qëllimin e politikave.
- Lobimi për emërtimin e femrave të kualifikuara në personelin e lartë si dhe përfshirjen e kuptimit dhe demonstrimit të përbetimit për barazinë gjinore, në aspektin e kushteve.²⁶
- Inicion programe të mentorimit që vendosin ekspertë gjinorë së bashku me personelin e lartë me qëllim të ndërtimit të kapacitetit gjinor të tyre.

Organet e koordinimit të sigurisë

Këshillat e Sigurisë Kombëtare (NSC) sigurojnë veprime të koordinuara në integrimin e një spektri të gjerë të politikave të lidhura me sigurinë, legjisllacionit, çështjeve strukturore dhe mbikëqyrjes. NSC – ose ndonjë organ i ngjashëm – mundet gjithashtu të formohet që të koordinojë politikën, të implementojë politikën, të vlerësojë ose këshillojë dhe të vendosë mjetet financiare për tu marrë me kërcënimet e sigurisë. Prandaj, këta organe koordinuese janë jetike, ndoshta madje edhe pika jo më e lehtë për qasje për të siguruar që çështjet gjinore janë të futura në agjendën dhe që femrat të marrin pjesë në sjelljen e politikave të sigurisë.

NSC në **Sierra Leone**, Zyra e Kabinet në **MB**, ose Këshilli Këshillues në **Kanada** kanë funksione të ndryshme, por të gjitha kanë për qëllim të centralizimit të mendimit të nivelit të lartë të qeverisë lidhur me çështjet e sigurisë kombëtare.²⁷ Gjithsesi, në demokracitë e reja dhe në shtetet post konfliktit kapaciteti i qeverisë që të menaxhojë dhe koordinojë përgjigjet për brengat e sigurisë kombëtare mundet të jetë i dobët.

Ngjashëm këta organe ndonjëherë dominohen nga forcat e armatosura dhe mungesa e baraspeshimit civil. Edhe pse NSC ose organet e ngjashme në shtetet e ndryshme kanë spektër të anëtarëve dhe mandateve të ndryshme, ata rrallë inkuadrojnë femra ose ju drejtohen çështjeve gjinore:

- Në Nepal ë vitin 2004, u formua NSC prej personelit të armatës dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të zyrës së Kryeministrit, por femrat nuk ishin përfshirë (me të vërtetë nuk kishte femra në poste të larta në polici ose në ministrinë kryesore të Qeverisë së Nepalit).
- NSC e Pakistanit ka një tërësi të ngjashme të kufizuar të anëtarëve sepse siguria kombëtare është e definuar ngushtë nën kapitullin e sovranitetit, integritetit, mbrojtjes, sigurisë së shtetit dhe "menaxhimit të krizave".²⁸ NSC e SHBA gjithashtu ka një komplet të ngushtë të anëtarëve, formalisht përfshirë Kryetarin, Nënkryetarin, Sekretarin Shtetëror dhe Ministrin (Sekretarin) e Mbrojtjes, me pjesëmarrje të rregullt të Shefit të Përbashkët të Stafit, Drejtorit të Agjencisë Qendrore për Zbulim dhe Këshilltarin e Sigurisë Kombëtare të Kryetarit.

Baraspeshimi gjinor i NSC së Pakistanit dhe të SHBA është i dobët, dhe çështjet lidhur me pasigurinë e meshkujve dhe femrave kryesisht nuk dallohen ose nuk merren në konsiderim. Njëra prej arsyeve për këtë është se këta organe kryesisht merren me brengat makropolitike, që nuk dallojnë grupe individuale në shoqëri.

Siç u theksua edhe në Seksioni 3.1, një spektër i përfitimeve rrjedhin nga rritja e pjesëmarrjes së femrave në vendim-marrjet e sigurisë. Për shembull, konsultimet me përfaqësuesit e komitetit drejtues të femrave parlamentare ka më shumë gjasa të zgjerojë diskutimin brenda NSC për atë se cilat brenga të sigurisë të jenë prioritare. Duke marrë në konsiderim çështjet gjinore mund të iniciohet një diskutim produktiv për qasjet e pranuar të sigurisë dhe prioriteteve të sigurisë, dhe të metodave efektive për sigurimin e sigurisë dhe drejtësisë.

Hapat e ndërmarra për integrimin e çështjeve gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së femrave në organet e koordinimit të sigurisë përfshijnë:

- Emërtimin e përfaqësuesve të femrave në NSC si çështje e prioritetit;
- Përfshirjen ose konsultimin me përfaqësuesit e ministrive të fokusuara në çështjet gjinore dhe të femrave, makinerinë tjetër qeveriste të gjinisë ose komitetet drejtuese të femrave parlamentare;
- Ndërtimin e kapaciteteve gjinore të anëtarëve të NSC nëpërmjet trajnimeve, informimeve të shkurtra, mentorimit dhe iniciativave të tjera. Shiko Seksionin 4.5 për Trajnim gjinor;
- Themelimi mekanizma për sigurimin e konsultimeve me ekspertë të jashtëm gjinor dhe përfaqësues prej organizatave të grave;

Njëra prej sfidave për rritjen e emërtimit të femrave në NSC është që femrat edhe më tutje janë të marginalizuara në shumicën e shteteve nga zyrtarët e larta të politikës dhe prandaj vetëm disa femra mbajnë poste të përfshira në këta këshilla. Për shembull, në vitin 2005 kishte vetëm 12 femra ministre të mbrojtjes dhe çështjeve të veteranëve (6.6%) dhe 29 (15.8%) femra ministre të drejtësisë në tërësinë prej 183 shteteve.²⁹ Iniciativat për rritjen e numrit të femrave në poste të larta politike janë gjithashtu të nevojshme, siç janë: bursat për femrat që të marrin pjesë në programe përkatëse universitare, ndërtimi i kapaciteteve të anëtarëve femra të parlamentit dhe kuotat brenda partive politike. Përfshirja e femrave në organet koordinuese të sigurisë nuk domethënë me domosdo se do t'ju kushtohet më shumë vëmendje çështjeve gjinore, por një diversitet të mendimeve dhe eksperiencave midis anëtarëve të NSC që do të sjellë një numër më të madh të perspektivave në tavolinë.

Komisionet për përpilimin e politikave të sigurisë

Nëse gjinia duhet kuptuar qartë në politikat e sigurisë, organet specifike të cilët draftojnë (përpilojnë) politikat e sigurisë duhet të kenë kapacitet të kuptojnë nevojat e ndryshme të sigurisë së meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve, dhe se si politika e propozuar e sigurisë do të ndikojë mbi këta nevoja. Organet e përpilimit të sigurisë

mund të jenë ose komisione të përhershme ose ad hoc komisione. Politikat mund të bëhen nga një ekip i njerëzve nga ministri e vetme (p.sh. politika e policisë) ose disa ministri (p.sh. për PSK).

Anëtarët e Komisionit për draftim duhet të kenë edhe aftësitë teknike për të përgatitur politikat të cilat janë gjithëpërfshirëse, precize dhe me kuptim të qartë. Kriteri kryesor për zgjedhjen e anëtarëve të anëtarëve të komisionit duhet të jetë si vijon:

- Aftësi teknike dhe dituri – përfshirë integrimin e çështjeve gjinore.
- Përfaqësim lidhur me agjencitë e implementimit dhe vendim-marrësit kryesor – sipas mundësive përfshirjen e një përfaqësuesi prej secilës ministri qeveritare përgjegjëse për çështjet gjinore.
- Përbetimi për reformat demokratike – përfshirë promovimin e barazisë gjinore.³⁰

Organet e mbikëqyrjes siç janë parlamenti ose CSO mund të luajnë rol të rëndësishëm në lobimin për përfshirjen e ekspertizës gjinore në komisionet e draftimit, ose që anëtarët e komisionit të kalojnë trajnimet që përfshijnë komponentët lidhur me gjinisë.

Për të siguruar politikë të sigurisë të bazuar në gjininë komisioni i draftimit duhet në mënyrë të veçantë t’ju drejtohet çështjeve gjinore dhe përdorimit të gjuhës së ndjeshme gjinore.

Adresimi i veçantë i çështjeve gjinore

Varësisht nga lloji i politikës së sigurisë që përpilohet, çështjet gjinore të cilat duhet të theksohen përfshijnë (shiko Shembulli 6):

- rëndësia e arritjes së barazisë midis meshkujve dhe femrave, dhe grupeve sociale, religjioze dhe etnike si çështje e sigurisë kombëtare;
- Afirmimi i të drejtave të barabartë për të gjithë meshkujt dhe femrat që të marrin pjesë në institucionet e sektorit të sigurisë;

- GBV kundër meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve si kërcënim kryesor i brendshëm i sigurisë; dhe strategjitë për parandalimin, përgjigjen dhe ndëshkimin e GBV, me vendosjen e resurseve përkatëse njerëzore dhe financiare;
- Eliminimi i diskriminimit brenda institucioneve të sektorit të sigurisë ose në dispozitat e shërbimeve të sigurisë në baza të seksit, racës, religjionit, orientimit seksual ose bazave të tjera joadekuate;
- Kodet e sjelljeve institucionale duke përfshirë dispozita të veçanta për diskriminimin, ngacmimin seksual dhe format e tjera të GBV.
- Formimi i mekanizmave të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në mbikëqyrjen e implementimit të politikave të sigurisë, RSS proceseve dhe institucioneve të sektorit të sigurisë.

Llojet e ndryshme të politikave të sigurisë në shtetet e ndryshme ju kanë drejtuar çështjeve gjinore në këtë mënyrë. Libri i Bardhë i Mbrojtjes të Sierra Leone-s thekson se "Ministria e Mbrojtjes së bashku me RSLAF [Forcat e Armatosura të Republikës së Sierra Leone-s] është përbetuar të rekrutojë dhe ruajë personel të kalibrit të lartë pa marrë parasysh fisin, rajonin, gjininë, religjioni ...".³¹ Trafikimi i qenieve njerëzore është përfshirë në Strategjinë përkatëse të Sigurisë Kombëtare të Rumanisë dhe Ukrainës. Në politikën e Ukrainës qëndron nën kapitullin "Sigurimi i kushteve të favorshme të jashtme për zhvillimin dhe sigurinë e shtetit".³² Në Rumani "strategjia ndërthet nevojat për implementimin e disa mjeteve për stimulimin e solidaritetit kombëtar dhe përgjegjësisë civile, interes në barazinë në punë midis meshkujve dhe femrave, mundësi të barabarta për qasje deri te arsimimi, dhe trajnimi dhe mbrojtja sociale".³³

Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore

Gjithashtu është me rëndësi të përdoret gjuhë e "përfshirjes së gjinisë" dhe "specifike e gjinisë" në politikat e sigurisë me qëllim që t'ë eliminohet diskriminimi ose përjashtimi. Përdorimi gjenetik i "ai" ose "burri" përjashton femrat. Shumë politika të lidhura me sigurinë, nga Libri i Bardhë i

Shembulli 6 Përgjigja gjinore në politikat e sigurisë të Afrikës Jugore

Libri i bardhë i Afrikës Jugore për Zbulim, Mbrojtje Kombëtare, dhe Mbrojtje dhe Siguri përfshin gjuhë të ndjeshme gjinore, dhe ju drejtohet GBV dhe diskriminimit dhe pjesëmarrjes së barabartë brenda institucioneve të sektorëve të sigurisë. Libri i Bardhë për Zbulimin (1994):

*Themelimi i shërbimit për zbulim kombëtar do të përplojë që të pasqyrojë edhe përbërjen gjinore edhe racore të shoqërisë përderisa gjithashtu do të përkujdeset që të ketë në konsiderim kriteret objektive të meritave. Në këtë aspekt, do të implementohen një program aksioni afirmativ që t'ju drejtohen disbalanceve.*³⁵

Libri i Bardhë për Mbrojtje i Republikës Jug Afrikane (1996):

Me qëllim që të sigurojë legjitimitetin e forcave të armatosura, MeM (Ministria e Mbrojtjes) është e përbetuar në qëllimin e tejkalimit të legjitimitetit racor dhe diskriminimit gjinor. Do të sigurojë që SANDF [Forcat Mbrojtëse Kombëtare të Afrikës së Jugut], dhe udhëheqësia e tyre në veçanti, të jetë gjërësisht e përfaqësuar nga popullata e Afrikës Jugore.

*MeM pranon të drejtën e femrës që të shërbejë në të gjitha gradat dhe pozitat, përfshirë edhe rolet luftarake.*³⁶

Libri i Bardhë për Mbrojtje dhe Siguri (1998):

*Në veçanti përmend trajtimin e ofendimeve seksuale, dhunimit dhe dhunës familjare me "dinjitet shtesë, ngushëllim dhe përkujdes". Gjithashtu kërkon strategji për parandalimin e krimit ndaj atyre grupeve të cilat më së tepërmi në rrezik ose prej ofendimeve ose prej të bëhen viktimat të krimit, përfshirë "komunitetet e varfra, rininë, femrat dhe fëmijët si dhe të personave me handikap".*³⁷

Mbrojtjes i Sierra Leone-s deri te Libri i Bardhë i Mbrojtjes i Irlandës, e kuptojnë këtë, për shembull duke referuar më termat meshkuj shërbyes dhe femër”. PSK e tjera, siç është ajo e Rusisë dhe e SHBA, nuk bëjnë dallim midis meshkujve dhe femrave. Derisa përdorimi i “gjuhë neutrale gjinore” – p.sh. “njerëz” në vend të “meshkuj ose femra” – është e pranueshme në shumë rrethana, ajo mund të kufizojë njohjen e dallimeve gjinore, me mund ta vendosë paragjykimin se të gjitha grupet në shoqëri kanë nevojë të ngjashme të sigurisë. Së fundi, ekzistojnë PSK siç janë ata të Xhamajkës, Gjeorgjisë dhe Ukrainës që edhe më tutje vazhdojnë të përdorin gjuhën siç është “fuqia mashkullore e punës” ose “rreziqet e shkaktuara nga meshkujt”.³⁴ Këta janë shprehje diskutabile diskriminuese që burojnë nga ideja se vetëm meshkujt (jo femrat) janë aktiv në jetën publike. Shembuj të gjuhës së ndjeshme gjinore përfshijnë:

- Shërbëtor dhe shërbëtores – jo shërbëtor
- Oficer i policisë – jo polic
- Qenie njerëzore – jo mashkullore
- Artificial ose i prodhuar – jo krijuar nga mashkulli
- Ajo/ai ose ai/ajo – jo ai
- Me personel – jo me burra
- Punë, personel, fuqi punues – jo fuqi punëtore mashkullore
- Kryesues ose Person kryesues – jo Kryetar
- Specifikon meshkujt, femrat, vajzat dhe djemtë ku është e mundur – e jo vetëm njerëzit

4.2 Parlamenti

Ekzekutivi propozon politikën e sigurisë dhe Parlamenti zakonisht i miraton ata, ndryshon ose refuzon politikën; kontrollon buxhetin; dhe mund të mbikëqyrë dhe vlerësojë implementimin e tyre (shiko Shembulli 7). Përderisa funksioni i parlamentit ndryshon prej shtetit në shtet, prej tij pritet që të përfshijë dy detyra kur bëhet fjalë për prodhimin e politikave:

monitorimin e ekzekutivit dhe përfaqësimin e interesave të qytetarëve. Kjo domethënë se Parlamenti mund të luajë rol të rëndësishëm në sigurimin e asaj që politika ti përgjigjet nevojave të veçanta të meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve, përfshirë nëpërmjet të: proceseve të sjelljes së politikave të sigurisë me pjesëmarrje dhe të përfaqësimit të barabartë të meshkujve dhe femrave, përfshirë grupet e ndryshme sociale, etnike dhe religjioze.

Shiko Mjetet Praktike për Mbikëqyrjen Parlamentare të RSS dhe Gjinisë

Në demokracitë e reja në zhvillim ose në shtetet post konfliktit, as koncepti e as praktikat e mbikëqyrjes demokratike dhe financiare nuk kanë gjasa reale të jenë në vendin e duhur. Një pasojë është mungesa e koordinimit dhe këmbimit të informatave midis autoriteteve civile dhe ushtarake, dhe mosbesimi nga ana e qeverisë dhe parlamentit që të pranojë mbikëqyrje civile. Llogaridhënia, transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në përpilimin e përgjigjeve për brengat e sigurisë kombëtare janë si pasojat e limituara. Gjithsesi, madje edhe nis parlamentet në demokracitë në zhvillim kanë mungesë të fuqisë së duhur thelbësore vendim-marrëse, ata janë potencialisht forume jetike për transparencë dhe mundën në mënyrë të rëndësishme në llogaridhënien e ekzekutivit dhe kontrollit të fuqisë ekzekutive.

Ngjashëm, në sistemet politike ku dominon disiplina e fortë partiake brenda legjislativit dhe komisioneve të tij, roli mbikëqyrës i parlamentit mundet praktikisht të jetë shumë i penguar. Në Kanada, parlamenti ka qenë kritikuar që ka qenë më shumë një vulë gume për vendimet politike të sjella në mënyrë të centralizuar nga ana e Kryeministrit dhe këshilltarëve të lartë politik dhe të kabinetit. Në politikën e mbrojtjes dhe sigurisë, Komisionet e legjislativit nuk kanë shërbyer si mekanizma efektiv për mbikëqyrje, dhe

Shembulli 7 Roli i Parlamentit në politikën e sigurisë³⁹

Zhvillimi

Pasi që përpilimi i politikave të sigurisë është detyrë e ekzekutivit dhe departamenteve dhe agjencive kompetente qeveritare, roli i Parlamentit në fazën e përpilimit është i kufizuar.

Vendim-marrja

Kur politika e sigurisë të arrijë në Parlament atëherë ai pranon përgjegjësinë e drejtëpërdrejtë mbi të. Parlamenti mund të jep pëlqimin e tij për politikën e reja dhe legjislativon të cilat i propozon qeveria, të refuzojë ata ose të sugjerojë ndryshime. Parlamenti gjithashtu ka rol të veçantë lidhur me përcaktimet e buxhetit nëpërmjet të fazës kryesore të ciklit tipik të buxhetit; përgatitjes së buxhetit, miratimit të buxhetit, realizimi ose shpenzimi dhe revidimi ose shqyrtimi. Shiko Seksionin 4.6 për analizën e buxhetit gjinor.

Korniza kohore e procesit të vendim-marrjes duhet të lejojë konsultime të mëtutjeshme publike me përfaqësuesit e seksioneve të ndryshme të popullatës. Kjo do të zmadhonte potencialin për mbështetje publike të politikës së sigurisë dhe do të sigurojë plotësimin e nevojave të popullatës.

Implementimi

Gjatë implementimit të politikave të sigurisë, është detyra e parlamentit që të vëzhgojë me kujdes aktivitetet e qeverisë, përfshirë këtu edhe nëpërmjet të analizave të buxhetit. Politikën e sigurisë kanë pasojat financiare madhore dhe janë thelbësore për paratë e tatimpaguesve.

Vlerësimi dhe leksionet e mësuara

Parlamenti ka një rol në revizionin edhe të shifrave edhe të performancës lidhur me implementimin e politikave të sigurisë. Raportet për përparimin nga agjencitë relevante qeveritare janë thelbësore për kontrollin e proceseve dhe marrjen e informatave të brendshme për atë se a thua qëllimet e parashtuara në politikën e sigurisë janë të implementuara.

Shembulli 8 | Integrimi i gjinisë në sjelljen e politikave të sigurisë: roli i femrave brenda ANC në Afrikën Jugore

Tranzicioni i Afrikës Jugore kah demokracia demonstroi se si mjedisi i favorshëm politik, formimi i ligës së grave brenda partive politike dhe lobimi për çështjet gjinore përgjatë spektrit mund të ndikojë mbi sjelljen e politikave të sigurisë kombëtare.

Hapësira politike për t'u drejtuar çështjeve gjinore ishte krijuar brenda shoqërisë civile dhe partive politike. Për shembull, bregat për marginalizimin e grave, Kongresi Nacional Afrikan (KNA) Liga e Grave ishte reformuar në vitin 1990 dhe kërkonte përfshirjen e femrave në pozitë udhëheqëse dhe ngërthimin e barazisë gjinore në platformat dhe politikat e KNA. Lobimi i tyre është i qartë në botimin e KNA të vitit 1992 *Gati për të qeverisur: Udhëzimet për një Afrikë Jugore Demokratike*. Dokumenti propozon përqafimin e katër vlerave të lidhura mes veti: demokraci dhe autoritetet civile, sigurinë njerëzore, kundër-militarizimin, dhe barazinë gjinore. Me theksin në këtë të fundit, manifesti thekson qëllimet e jo-seksizmit, dhe nevojës për krijimin e agjencive speciale për të siguruar implementimin e politikës së mundësive të barabarta. Lidhur me institucionet e sektorit të sigurimit, manifesti thekson që ata duhet të respektojnë idealet e demokracisë, jo-racizmit, dhe jo-seksizmit; të pasqyrojnë përbërjen kombëtare dhe gjinore të shoqërisë së Afrikës Jugore; dhe të kuptojnë se "diskriminimi gjinor ose ka përjashtuar ose ka nënçmuar pjesëmarrjen e femrave në të gjitha institucionet socio-ekonomike dhe politike".⁴³

Femrat anëtare të KNA dhe shoqërisë civile ishin gjithashtu të akredituara për theksimin e fokusit të sigurisë njerëzore, duke kthyer diskutimin nga çështjet e "sigurisë shtetërore" në siguri si një brengë e përgjithshme e gjerë e bazuar në njerëzit. Kjo reflektohet në miratimin eksplicit të Gati për Qeverisje të qasjes njerëzore dhe kërkesave për demilitarizimin e sigurisë me dimensionet politike, ekonomike, sociale dhe të mjedisit.

është menduar se ata nuk po bëjnë diskutime thelbësore të vërteta për politikat e mbrojtjes të cilat po ndodhin në parlamentin e Kanadasë.³⁸

Proceset e sjelljes së politikave me pjesëmarrje

Involvimi i Parlamentit në politikat e sigurisë është kritik për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj popullatës. Kjo arrihet nëpërmjet të debateve të hapura, konsultimeve dhe qasjen publike deri te informatat për politikat qeveritare të sigurisë.

Konsultimet me komisionet relevante të Parlamentit për PSK – dhe politikat e tjera të sigurisë – do të jenë më të suksesshme nëse barten në një fazë të hershme në procesin e draftimit me qëllim që të munden të kryen ndryshimet dhe ri-draftimet e politikës. Parlamentarët dhe komisionet parlamentare nuk duhet të prezantohen vetëm me dokumentin përfundimtar, të cilin ata duhet ose ta miratojnë ose ta refuzojnë.

Parlamentet – përfshirë komisionet e mbrojtjes dhe të sigurisë – duhet gjithashtu të jenë në ballë të sigurimit që politika e sigurisë të kalojnë nëpër konsultimet përkatëse publike. Edhe pse proceset nuk janë me domosdo me kosto të madhe financiare, ata kërkojnë kohë, fonde, resurse njerëzore dhe dëshirë politike që ndoshta nuk është në dispozicion në vend në shtetet post konfliktit dhe në shtetet në zhvillim. Prandaj mund të nevojitet mbështetja e donatorëve për mbulimin e shpenzimeve, për shembull, të punëtorëve në zonat rurale. Donatorët munden gjithashtu të financojnë proceset e konsultimit që në mënyrë specifike janë përpiluar për femrat dhe grupet e tjera që janë shpesh herë të marginalizuara gjatë përpilimit të politikave të sigurimit.⁴⁰

Mekanizmat për sigurimin e pjesëmarrjes mund të përfshijnë:

- Konsultimet e strukturuar me segmentin përfaqësues të CSO, përfshirë organizatat e grave urbane dhe rurale (shiko Shembulli 10);
- Takime në sallën e Këshillit Komunal me interaksion mes liderëve politik dhe publikut;
- Dëgjime parlamentare dhe debate të hapura;

- Sipas nevojës, takime të veçanta me grupet e marginalizuara në nivel lokal, të cilat ndoshta nuk do të marrin pjesë në takimet publike me popullatën shumicë;

Të sigurojë pjesëmarrje të gjerë dhe reprezentative të masave specifike të cilat duhet të ndërmerren që të përfshijnë:

- Organizatat e grave të komuniteteve urbane dhe rurale;
- Sindikatat e punëtorëve;
- Organizata fetare;
- Liderët e komunitetit dhe aktivistët;
- Organizatat rinore;
- Shoqatat vendore, etnike dhe të tjera minoritare;
- Shoqatat për personat me handicap;
- Grupet e lobimit për fëmijët;
- Akademikët dhe shkencëtarët;
- Shoqatat e emigrantëve;
- Ekspertët gjinor;
- Organizata ndërkombëtare;
- Organizatat për drejtësi sociale dhe shërbimet;

Përfaqësimi i barabartë i meshkujve dhe femrave

Parlamentarët janë në kontakte të rregullta dhe të drejtpërdrejta me popullatën në përgjithësi, në praktikë më shumë se ekzekutivi, dhe prandaj janë në pozitë të mirë që të shqiptojnë disa brenga të sigurisë publike. Nga perspektiva për përfaqësim të barabartë, gjithsesi, shkalla e femrave dhe meshkujve në shumicën e parlamenteve në botë është e pabarabartë. Në vitin 2006, 83.1% të parlamentarëve në përgjithësi ishin meshkuj.⁴¹

Si shtesë, femrat parlamentare rrallë kanë vend në komisionet parlamentare të lidhura me çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë. Prandaj, për të siguruar informata nga femrat parlamentare në sjelljen e politikave të sigurisë mund të jetë adekuate që të:

- Rritet numri i femrave parlamentare në komisionet e mbrojtjes dhe të sigurisë, përfshirë edhe si kryesues;
- Inkurajojmë femrat të takohen përtej vijës partiake lidhur

më çështjet e sigurisë dhe të përpilojnë platforma të përbashkëta dhe strategji të përbashkëta për informata në diskutimet për politikën më të gjerë;

- Mbështetjen e themelimit të Komiteteve drejtuese të femrave në parlament dhe brenda partive politike (shiko Shembulli 8);
- Inkurajojmë themelimin e kuotave kombëtare ose partiake për pjesëmarrje minimale të femrave dhe meshkujve;

Si shtesë për sigurimin e përfaqësimit të barabartë, është me rëndësi që të ngremë vetëdijen dhe kuptimin e çështjeve gjinore në mesin e parlamentarëve, në veçanti të meshkujve dhe femrave anëtare të komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë.

4.3 Vetëqeverisja lokale

Me qëllim që të sigurojmë implementim të plotë të politikave të sigurisë në nivel kombëtar, iniciativat duhet që të ndërmerren në nivel lokal. Si shtesë, komisionet e sigurisë në nivel lokal, për shembull, mund të sigurojnë informata thelbësore në politikën e sigurisë në nivel kombëtar, duke siguruar që ata pasqyrojnë realitetet dhe prioritetet lokale të sigurisë. Eksperiencat tregojnë se analizat dhe strategjitë e ngërthyera lokale të sigurisë janë jetike në garantimin se jo-sigurinë në nivel të komunitetit në mënyrë të duhur janë trajtuar. Këta iniciative mund të përbëjnë pikën kryesore hyrëse për integrimin e çështjeve gjinore në implementimin e politikave të sigurisë.

Shembujt e iniciativave të cilat mund të ndërmerren nga vetëqeverisja lokale, institutet lokale të sektorit të sigurisë, ose shoqëria civile përfshijnë:

- Revidimin e sigurisë/ mbrojtjes;
- Planet e sigurisë të qytetarëve/ komunitetit;
- Komisionet dhe këshillat për sigurinë/ mbrojtjen;
- Forumet policore të komunitetit.

Forumet policore të komunitetit, planet e sigurisë dhe revidimet e mbrojtjes

Në **Afrikën Jugore**, vetëqeverisja lokale dhe Forcat Policore të Afrikës Jugore marrin pjesë në, dhe bashkëpunojnë me, Forumet Policore të Komunitetit (CPF) për të përcaktuar prioritetet dhe qëllimet për parandalimin e krimit. CPF involvon CSO në formulimin e prioriteteve të policisë dhe iniciativave për parandalimin e krimit. Aktivitetet e CPF janë të bazuara në planet e sigurisë të komunitetit, të cilat identifikojnë: programet, projektet dhe aksionet të cilat do të implementojë CPF; ku CPF do të përfitojë fonde për projektet; dhe si projekti do të promovojë qëllimet e CPF. Në anën tjetër, planet e sigurisë të komunitetit janë të bazuara në revidimet e mbrojtjes së komunitetit të cilat ndihmojnë që të:

- Fokusohehen në problemet më serioze kur keni vetëm disa resurse;
- T'ju japin njerëzve fakte kur ata nuk dakordohen lidhur me problemet më serioze;
- Koordinojnë punën e organizatave të ndryshme që të parandalojnë dyfishimin.

Revidimi i sigurisë së komunitetit bëhet nëpërmjet procesit me pesë hapa për të identifikuar:

1. **Problemet e krimit në komunitet:** p.sh. dhunën familjare;
2. **Cilat organizata e bëjnë atë:** Disa organizata madje edhe mund të kenë projekte për parandalimin e krimit, dhe prandaj tanimë mund të kenë aktivitetet për parandalimin e dhunës familjare dhe mbështetjen e atyre që janë të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte;
3. **Karakteristikat fizike dhe sociale të zonës:** Për të kuptuar shkaqet e krimeve në shoqëri, ju duhet të dini karakteristikat fizike dhe sociale të zonës. Për shembull: të rinjtë kanë shpesh më shumë gjasa që të kryejnë krime; femrat janë më shumë në rrezik nga dhuna familjare dhe sulmet seksuale; të rinjtë janë më shumë në rrezik për krime të tjera të dhunshme; të rinjtë gjithashtu ka më shumë gjasa të kryejnë krime.
4. **Problemet të cilat janë më të rëndësishmet.**
5. **Detajet e problemeve më të rëndësishme⁴⁴.**

Shembulli 9 Komisionet e sigurisë lokale dhe mekanizmat e lajmërimit të hershëm në Sierra Leone ⁴⁶

Në Sierra Leone, Zyra e Sigurisë Kombëtare (ONS) themeloi Komisionet Provinciale të Sigurisë dhe Komisionet e Qarkut të Sigurisë si forume të konsultimit në nivel lokal për të vlerësuar dhe t'ju përgjigjur kërcënimeve të sigurisë nëpër tërë shtetin. Ata gjithashtu janë vendosur në vend që të sigurojnë që politikën ekzistuese të sigurisë reflektojnë nevojat vjetore të sigurisë dhe grumbullojnë informata nga niveli i komunitetit. Komisionet e decentralizuara të sigurisë të vendosura në brendinë e shtetit mund të shërbejnë edhe si mekanizma për lajmërimin e hershëm të konfliktit për qeverinë, sepse ata raportojnë drejtpërsëdrejti pranë ONS.

Përfshirja e femrave ose e përfaqësuesve të organizatave të grave në këta organe deri tani ka qenë e kufizuar, por do të përmirësojnë aftësinë të grumbullojnë të dhëna si pjesë e mekanizmit për lajmërim të hershëm. Qasja nga poshtë lart e kësaj natyre mundet të kombinohet me rekrutimin e këshilltarëve gjinor të ONS të cilët do të jenë të aftë të analizojnë dhe strukturojnë të dhënat e pranuar nga Komisionet Provinciale dhe Qarkore të Sigurisë dhe të parashtrajnë pyetje relevante siç janë:

1. A thua institucionet e sektorit të sigurisë përgjigjen në mënyrë të duhur për nevojat e sigurisë të meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve?
 - a. A thua meshkujt dhe femrat kanë lirinë që të lëshojnë shtëpitë e tyre ose të udhëtojnë jashtë qarkut të tyre?
 - b. A thua janë të ndjeshëm meshkujt, femrat, vajzat dhe djemtë ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe eksploatimit seksual?
 - c. Çfarë shërbime ka në qasje për meshkujt dhe femrat që vuajnë nga dhuna familjare?
2. Çfarë lloje të shkallëve të GBV ekzistojnë? A thua GBV po rritet ose po zvogëlohen?
3. A thua ka resurse të mjaftueshme në komunitet për t'ju përgjigjur kërcënimeve të ndryshme të sigurisë që i përjetojnë meshkujt dhe femrat e grupeve të ndryshme sociale?

Shembulli 10 | Politika Kombëtare e Sigurisë të Xhamajkës – një proces përfshirës ⁵⁰

Në mesin e vitit 2007 Qeveria e Xhamajkës miratoi një Politikë Kombëtare të gjithëmbarshme të sigurisë – *Drejt një Kombi të sigurt dhe progresiv*. Kjo politikë ishte e bazuar në Librin e Gjelbër të Strategjisë të Sigurisë Kombëtare e cila për herë të parë u dorëzua në Parlament në janar të vitit 2006, si dhe Libri i bardhë pasues për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Libri i Bardhë ishte përpiluar pas një numri të madh të konsultimeve me komunitetet e Xhamajkës dhe palët e interesuara, përfshirë CSO.

PSK është e obliguar me qëllimet e gjera të politikës shpirtërore dhe sektoriale të mendimeve dhe iniciativave ekzistuese të RSS, dhe ishte rezultat i bashkëpunimit midis qeverisë së Xhamajkës dhe Kanadasë, MB dhe SHBA dhe këshilltarëve. Fillimisht qeveria e Xhamajkës planifikoi të zbatojë një pasqyrë të mbrojtjes. Gjithsesi, së shpejti u kuptua se kërkohej një qasje më e gjerë për t'ju adresuar spektrit ekzistues të rreziqeve potenciale ndaj sigurisë kombëtare, përfshirë krimin e organizuar, dhunën e bandave, bregat socio-ekonomike dhe katastrofën e mjedisit jetësor. U inicia një konsultim me përmasa të gjera, duke përfshirë të gjithë degët relevante të qeverisë dhe agjencive shtetërore dhe CSO, përfshirë këtu edhe grupet e femrave.

Rezultati ishte një politikë kombëtare e sigurisë e cila ju drejtohet të gjitha institucioneve kryesore të sigurisë dhe drejtësisë, përfshirë edhe forcat e armatosura, policinë, Ministrinë e Drejtësisë dhe palët e interesuara joqeveritare. Ajo integron politikat kryesore të vendit, qëllimet dhe përgjegjësitë në një plan të gjithëmbarshtëm për plotësimin e "Vizionit Kombëtar" për Xhamajkën. PSK përshkruan përdorimin e kombinuar të instrumenteve politike, ekonomike, sociale dhe informative dhe të sigurisë për rritjen e sigurisë dhe drejtësisë. Ai qartëson kornizën institucionale brenda të cilave forcat e armatosura dhe institucionet qytetare të shtetit do të koordinojnë aktivitetet e tyre për krijimin e një rrjeti të integruar, të përbashkët të sigurisë për mbrojtjen e interesave kombëtare. Ai gjithashtu ju drejtohet edhe roleve komplementare dhe përgjegjësi të sektorëve publik dhe privat si edhe CSO.

Nën kapitullin "Efektet e dhunës në komunitet" PSK kërkon vëmendje më të madhe për ndikimin e dhunës mbi individët, komunitetet dhe shoqërisë. "Dhuna familjare" theksohet aty, "është njëra nga format më depërtuese dhe të rëndomta të dhunës që e helmojnë shoqërinë. Ajo kontribuon në modelin e përgjithshëm të krimit dhe dhunës si rezultat i efekteve të saja të molisjes në sferën sociale dhe në rolin e saj në socializmin e rinisë me dhunën si mjet për zgjidhjen e konflikteve. Femrat dhe fëmijë janë në rrezik jo-proporcional prej dhunës familjare".

Duke ndjekur miratimin e PSK, sfida tani është implementimi i tij. Njësia Kombëtare për Implementimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë është themeluar tanimë, e cila punon në emër të Këshillit për Siguri Kombëtare. Ajo ka për detyrë të koordinojë punën e ministrive relevante.

Komisionet lokale të sigurisë dhe planet civile të sigurisë

Lloje të ndryshme të organeve janë themeluar që të planifikojnë, koordinojnë dhe monitorojnë për përmirësimin e sigurisë lokale (shiko Shembulli 9).

Në Peru, parlamenti themeloi Sistemin e Sigurisë Qytetare Kombëtare për të promovuar pjesëmarrjen lokale në iniciativat për parandalimin e krimeve dhe për të bërë policinë më përgjegjëse ndaj komunitetit. Ky sistem mbështetet në institucionet lokale të sigurisë, me themelimin e Këshillave të Sigurisë Qytetare Lokale (LCSC) (Consejos Distritales de Seguridad Ciudadana). Në LCSC, komandantët e policisë lokale punojnë drejtpërdrejtë me autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e komuniteteve për parandalimin e krimit. LCSC mund të përshkruhen si mekanizma prej poshtë lartë për të mbajtur në llogaridhënie policinë për sjelljet e tyre dhe cilësinë e shërbimeve dhe të ofrojnë një hapje të rëndësishme për pjesëmarrjen e komunitetit në çështjet lokale të sigurisë. Ata janë të mandatuar të përpilojnë planet qytetare të sigurisë në nivel komunal në bazë të një vlerësimi të sigurisë lokale dhe çështjeve të sigurimit. Plani i sigurisë impementohet me mobilizimin e bashkëpunimit lokal dhe resurseve. LCSC janë gjithashtu përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit të planeve dhe monitorimin e performancës të nëpunësve publik në implementimin e planit, përfshirë edhe policinë. ⁴⁵

Organe të ngjashme siç janë Këshillat Lokale të Sigurisë (Consejos de Seguridad) janë themeluar në Kili, Kolumbi dhe Guatemalë. Në Kolumbi, anëtarët e Këshillit Lokal të Sigurisë kanë përfshirë edhe policinë lokale dhe komandantët e ushtrisë, kryetarin e komunës dhe përfaqësuesit prej

sektorit akademik dhe privat.

Shembuj të masave për të ndërmarrë për integrimin e çështjeve gjinore në iniciativat e sigurisë të vetëqeverisjes lokale:

- Përfshijnë ekspertë gjinor dhe përfaqësues prej organizatave të grave në komisionet/ këshillat e sigurisë të komuniteteve.
- Sigurojnë që revidimi i sigurisë të komunitetit të përfshijë: konsultime me femrat, meshkujt dhe grupet e ndryshme sociale në baza të barabarta, me fokusim në GBV; të dhënat e grumbulluara për gjininë, moshën, përkatësinë etnike dhe fqinjësinë; dhe çështje specifike lidhur me nevojat e ndryshme të sigurisë të grupeve që përbëjnë zonën nën juridiksionin e vetëqeverisjes lokale. Shiko Seksionin 4.6 për Llogaritjen, Monitorimin dhe Vlerësimin.
- Të marrin në konsiderim nevojat e ndryshme të sigurisë të meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve kur përpilojnë dhe implementojnë iniciativat për parandalimin dhe përgjigjen ndaj krimit.
- Komunikojnë rezultatet e revizionit të sigurisë dhe proceseve të planifikimit të organeve rajonale dhe kombëtare të sigurisë. Këta të dhëna janë kritike për sigurimin e asaj që politikat e sigurisë rajonale dhe kombëtare reflektojnë realitetet e strukturës lokale, dhe në disa kontekste edhe si mekanizma për lajmërimin e hershëm të konfliktit.
- Mundësojnë trajnime dhe udhëzime për ndërtimin e përgjigjes së qasjes gjinore midis personave të angazhuar në përpilimin e planeve të sigurisë në nivel të komuniteteve. Shiko Seksionin 4.5 për Trajnimin gjinor.

4.4 Organizatat e shoqërisë civile (CSO)

Një arsye e rëndësishme për përfshirjen e CSO në përpilimin dhe implementimin e politikave të sigurimit është që të sigurojë proces demokratik, transparent, llogaridhënës dhe përfshirës. CSO nuk paraqesin nga vetë definicioni këta parime të qeverisjes së mirë, dhe, e panevojshme të thuhet, nuk janë homogjene lidhur me interesat e tyre ekonomike dhe politike. Gjithsesi, shoqëria civile potencialisht mundëson hapësirë për ndërtimin e ekspertizave dhe kapaciteteve për vlerësim të pavarur, sfida ose verifikimin e analizave qeveritare dhe vendimeve të çështjeve të mbrojtjes dhe sigurisë. CSO ngërthejnë një spektër të gjerë të organizatave të ndryshme, përfshirë organizatat e grave, sindikatat e punëtorëve, grupet religjioze, shoqatat vendore etnike ose minoritare, shoqatat profesionale afariste, OJQ, think tanks dhe fondacionet, grupet hulumtuese, media grupet dhe institucionet e trajnimit. Kjo llojshmëri është edhe fuqi por edhe dobësi. Kjo është fuqi sepse ka potencial të përfaqësojë një spektër të gjerë të grupeve në shoqëri të cilat jo domosdo kanë zërin e tyre në proceset e sjelljes së politikës. Kjo është dobësi sepse gjetja e pikave të përbashkëta është një ushtrim sfidues dhe konsumon kohë, në veçanti lidhur me çështjet për sjelljen e politikave.

Shiko Mjetet praktike për mbikëqyrjen e Shoqërisë civile mbi RSS dhe Gjininë

Përpilimi i politikave lidhur me sigurinë kombëtare në të kaluar ka qenë rrethuar me fshehtësitë, që të cilën në një shkallë e kanë edhe nevojë kërkesat për siguri kombëtare. Gjithsesi, nëse procesi po zbatohet saktësisht si një proces brenda qeveritar, ai do të jetë kundër produktiv. 47 Fshehtësia mund të mbulojë keqpërdorimet financiare nëpërmjet të korrupsionit ose mungesës së ekspertizës/ Një mënyrë e tejkalimit të këtij problemi është që të sigurohet që llojet e informatave dhe të dokumenteve mund të klasifikohet si të fshehta dhe të kuptohen padysim sipas ligjit të statutit, përdërisa në të njëjtën kohë ruhet liria e të shprehurit dhe liria e shtypit.⁴⁸

CSO mund të ndërmarrë cilat do prej aksioneve vijuese për mbështetjen e sjelljes së politikave të sigurisë për tu përgjigjur kërkesave gjinore:

- Të ndikojë politikën publike nëpërmjet të lobimit lidhur me politikat e reja dhe ligjet për policinë, zbulimin, reformat e mbrojtjes ose sigurisë kombëtare;
- Krijon një klimë të politikës të favorshme dhe pjesëmarrëse duke ngritur vetëdijen e popullatës për PSK dhe politikave të sigurisë, dhe dimensionit të tyre gjinor;
- Mundësojë një tog të ekspertëve teknik për sjelljen e politikave që të mbështeten në ata të cilët kanë kapacitete specifike dhe shkathtësi në analizat gjinore;
- Mbështet përpilimin e politikës së sigurisë nëpërmjet të hulumtimeve në nivel të komunitetit për nevojat e sigurisë, duke dalluar midis nevojave të meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve;
- Monitoron implementimin e politikave të sigurisë dhe veprimet e institucioneve të sektorëve të sigurisë për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies publike;
- Paraqet shikimet dhe preferencat e qytetarëve lidhur

me sigurinë – përfshirë grupet e marginalizuara – që janë komponentë kritike të PSK përfshirëse/ përpilimit të politikës së sigurisë dhe mund të zgjerojnë debatet për atë së çka është “siguria”;

- Inkurajojnë pronësinë lokale të procesit të politikave jashtë institucioneve shtetërore;
- Ndërtojnë kapacitetet e personelit të qeverisë dhe parlamentarëve duke prodhuar dhe shpërndarë informata siç janë njoftime për politikat lidhur me bregat dhe nevojat e sigurisë në nivel të komunitetit;
- Promovojnë mbikëqyrjen e përpilimit të politikave të sigurisë nëpërmjet raportimeve në media dhe ndërtim të kapacitetit të gazetarëve për politikat e sigurisë dhe çështjet gjinore;
- Lehtëson dhe merr pjesë në debate publike për çështje jetike të mbrojtjes dhe sigurisë.
- Draftim dhe shpërndarje të analizave të pavarura dhe informatave për sektorin e sigurisë për parlamentin dhe popullatën;
- Të ofrojë ndërtim të kapaciteteve të qeverisë, parlamentit dhe CSO tjera për politikat gjinore dhe të sigurisë nëpërmjet punëtorive dhe trajnimeve;
- Zbaton revizionin gjinor dhe vlerësimin, përfshirë analizat e buxhetit gjinor, të politikës së sigurisë dhe institucioneve të sektorit të sigurisë;
- Lobimi për debate publike për çështjet e sigurisë dhe të bëjë disa informata të caktuar në dispozicion për popullatën.

Organizatave të grave

Organizatave të grave dhe organizatat që merren me çështjet gjinore kanë ekspertizë të caktuar dhe qasje deri te informatat gjë që i bën ata partnerë të vlefshëm për CSO e tjera, parlamentin, institucionet e sektorit të sigurisë dhe qeverisë në procesin e elaborimit të politikave të sigurisë. Ata mundën shpesh të shërbejnë si lidhje kritike midis realitetit të pasigurisë të cilën e eksperiencojnë meshkujt dhe femrat në nivel të komunitetit, dhe të atyre që sjellin vendimet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Organizatat e fokusuar kah gjinitë që veprojnë në nivel të komuniteteve shpesh kanë rrjetë të rrënjëzuar që ju mundësojnë atyre të identifikojnë nevojat thelbësore të sigurisë të grupeve të anashkaluar të shoqërisë. Të dhënat e tilla mund të kenë rëndësi të veçantë, edhe në procesin e përpilimit të revizioneve në sektorin e sigurisë edhe si lajmërues të hershëm të konflikteve, që nga një anë janë jetike për përcaktimin e prioritetëve kombëtare të sigurisë. Mënyrat e angazhimit të organizatave të grave në debatet për politikat e sigurisë dhe formulimet përfshijnë:

- Lehtësojnë ndërveprimin midis grupeve të grave dhe dhënësve të sigurisë lokale, për shembull nëpërmjet të përfshirjes së tyre në komisionet e sigurisë lokale;
- Ndërtojnë kapacitetet e organizatave të grave për politikat e sigurisë përfshirë lobimin dhe mbikëqyrjen;
- Përfshijnë përfaqësues prej organizatave të grave si ekspertë gjinor në dëgjimet parlamentare ose zbatojnë trajnime gjinore.

ОГО можат да бидат помоќни кога зборуваат во еден CSO mund të jenë edhe më të fuqishme kur flasin me një zë. Një shembull të ndikimit që mund të ketë rrjeti i CSO është Grupi Punues i OJQ për femrat, paqen dhe sigurinë.

U themelua në maj të vitit 2000 nga 11 organizata të ndryshme për lobimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për femrat, paqen dhe sigurinë. Si rezultat i lobimit intensiv dhe aktivitetit të madh, UN SCR 1325 u miratua njëzetë në 31 tetor të vitit 2000. Që atëherë fokusi i Grupit Punues të OJQ ka ndryshuar në mbështetjen e implementimit të UN SCR 1325 nëpërmjet të promovimit të perspektivës gjinore dhe respektimit të të drejtave të njeriut edhe në paqe dhe siguri, parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve dhe iniciativat për ndërtimin e paqes të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara⁴⁹.

4.5 Trajnimi gjinor

Trajnimi gjinor duhet të mundësohet për të gjithë pjesëmarrësit ndryshëm të përfshirë në procesin e sjelljes së politikave të sigurisë me qëllim që të mbështet përpilimin dhe implementimin e politikave gjinore. Kërkesa për trajnime gjinore mund të burojë nga vetë përpiluesit e politikave ose nga organet mbikëqyrëse siç janë parlamenti dhe CSO. Që trajnimi të jetë më efektiv, ai duhet të jetë i përpiluar enkas për të plotësuar nevojat dhe detyrat e grupit të caktuar, të fokusohet në shembujt praktik, të jetë i shoqëruar me materiale dhe burime relevante dhe të monitorohet dhe vlerësohet.

Shiko Mjete praktike për Llogaritjen, Monitorimin dhe Vlerësimin dhe Gjinisë

Target grupet kryesor për trajnimet gjinore të atyre që përpilojnë politikat e sigurisë janë:

- Personeli i ministrive relevante, përfshirë edhe ministrinë e mbrojtjes, të brendshme dhe të jashtme;
- Anëtarët e PSK;
- Parlamentarët në komisionet e mbrojtjes dhe sigurisë dhe personeli i tyre;
- Anëtarët e këshillave lokale qytetare të sigurisë ose forumet policore të komunitetit;
- CSO që punojnë në politikat e sigurisë;

Pjesëmarrës të ndryshëm mund të realizojnë trajnime gjinore, prej CSO me ekspertiza të specializuara në këtë sferë deri te ekspertët qeveritar gjinor. Temat potenciale për trajnimet gjinore mund të përfshijnë:

- Nevojave të ndryshme të sigurisë së meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve;
- Reduktimi i diskriminimit, ngacmimet seksuale dhe GBV nga personeli i sektorit të sigurisë;
- Strategjitë të cilat zvogëlojnë GBV;
- Kornizat ligjore dhe normative ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të cilat theksojnë të drejtat dhe qasjet e barabarta ët meshkujve dhe femrave;
- Rritjen e rekrutimit, mbajtjen dhe avancimin e femrave brenda institucioneve të sektorit të sigurisë;
- Mekanizmat për rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, përfshirë këtu edhe organizatat e grave, në proceset e sjelljes së politikave të sigurisë;

- Vlerësimi i ndikimit të politikës gjinore;
- Analizat e buxhetit gjinore.

Së bashku me trajnimet specifike për çështjet gjinore, temat gjinore mund të integrohen edhe në trajnimet e fokusuar në çështjet e sigurisë. Ky opsioni i fundit mund të tregohet si qasje më efektive për kontekstualizimin e rëndësisë së gjinisë midis aktorëve të sektorit të sigurisë. Me qëllim që, për shembull, të ndërtojme kapacitetet të parlamentarëve për mbikëqyrjen e proceseve të sjelljes së politikave të sigurisë, nevojiten trajnime për analizat strategjike dhe formulimin e politikave si edhe për mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë⁵¹.

4.6 Llogaritja, monitorimi dhe vlerësimi

Proceset e llogaritjes gjithëpërfshirëse, monitorimit dhe vlerësimit (M&E) ndihmojnë në sigurimin që politika e sigurisë të plotësojë nevojat e meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve dhe në atë që proceset e formulimit dhe implementimit të përmbushin qëllimet e tyre të parashikuara. Çështjet gjinore mund të integrohen në llogaritjet ekzistuese dhe në ME kornizën, ose mund të ndërmerren revizione specifike gjinore dhe vlerësime të ndikimit (ose që të dyja). Këta procese duhet të ndërmerren si pjesë e proceseve zyrtare për sjelljen e politikave të sigurisë, por gjithashtu mund të përdoren edhe si mjet praktik për mbikëqyrjen nga parlamentarët dhe CSO.

Shiko Mjetet praktike për trajnimin gjinore për personelin e sektorit të sigurisë

Llogaritja e ndikimit të gjinisë

Llogaritja e ndikimit të gjinisë të politikave të sigurisë ndihmon në përcaktimin e politikave mbi meshkujt, femrat, vajzat dhe djemtë (shiko Shembulli 11). Edhe pse është më mirë të zbatohet llogaritja derisa politika është në formulim të saj dhe kur ndryshimet mund të kryhen, mundet gjithashtu të jetë një mjet praktik i leverdishëm për përcaktimin se a thua vallë nevojitet revizioni i politikës.

Gjinia dhe analizat socio-ekonomike

Një analizë gjinore dhe socio politike e miratuar gjithashtu mundet të angazhohet, edhe në përpilimin e politikës së sigurisë edhe si instrument për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të saj. Nëpërmjet të analizave të gjinisë, më mirë kuptohen rolet dhe marrëdhëniet e gjinive ekzistuese, në veçanti dallimet në aktivitetet, qasjet te resurset dhe vendim-marrjet dhe pengesat ekonomike, sociale, politike dhe të tjera të ballafaquara nga femrat dhe meshkujt. GSE analiza merr në konsiderim sfidat e shumëfishta të eksperiencuara kur gjinia ndërlihet me pabarazitë e tjera që ballafaqohen femrat dhe meshkujt siç janë klasa, përkatësia etnike, kultura dhe religjioni.

Prandaj GSE analiza e aplikuar gjatë përpilimit dhe implementimit të PSK dhe politikave të tjera të sigurisë mund të ndihmojë sigurimin e efektivitetit të politikës për të gjithë anëtarët e institucioneve, shtetit dhe komunitetit.

Shembulli 11 Llogaritja e ndikimit të gjinisë në politikat e sigurisë ⁵²	
Hapat:	<i>Pyetjet për tu parashtruar:</i>
Hapi 1: Definoni çështjet dhe qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> ■ Çka dëshiron të arrin politika dhe kush do të përfitojë nga ajo? ■ A thua politika plotëson nevojat e ndryshme të sigurisë të meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve? A janë të drejtuara çështjet e GBV, siç është dhuna familjare dhe trafikimi i qenieve njerëzore? A thua është përfshirë edhe preventiva? ■ A thua theksi është në sigurinë kombëtare ose njerëzore? ■ A është në vazhde politika me mandatet ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për çështjet gjinore? ■ A është e dedikuar politika të tejkalojë pabarazitë gjinore ose eliminojë barrierat dhe, nëse po, a thua duhet të ekzistojë qëllim për barazinë gjinore? ■ A thua është përfshirë gjuha specifike gjinore dhe e ndjeshme gjinore? ■ Çka thonë meshkujt dhe femrat, përfshirë këtu edhe CSO gjinore/ të grave ose Ministria e femrave thonë lidhur me çështjet dhe rezultatet?
Hapi 2: Grumbullimi i të dhënave	<ul style="list-style-type: none"> ■ Si do të konsultohen palët e interesuara dhe grupet e ndryshme të femrave dhe meshkujve? ■ A thua organizatat përfaqësuese me të vërtetë pasqyrojnë zërin e meshkujve dhe femrave që presin përfitim nga politika? Nëse jo, cila është strategjia për të arritur te ata? ■ Cila është përbërja e njerëzve të prekur nga politika? ■ Si munden të dhënat dhe informatat statistikore të grumbullohen në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, handicapit, moshës, religjionit dhe orientimit seksual? ■ Cilat informatat të tjera përveç informata për ndarjen e gjinive nevojiten për të kuptuar çështjen? ■ Cilat janë rreziqet e konsultimit të hershëm – si do të menaxhohen pritjet dhe interesat e konfliktit?
Hapi 3: Opsionet e përpilimit	<ul style="list-style-type: none"> ■ Si ndikojnë rekomandimet ose secili opsion në mënyrë negative ose pozitive te femrat dhe meshkujt? ■ A thua rekomandimet ose opsionet e tjera përforcojnë ose sfidojnë perceptimet tradicionale ose stereotipat e femrave dhe meshkujve? ■ Cilat opsione ju japin meshkujve dhe femrave zgjidhje të vërtetë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë në shoqëri? ■ A thua ekziston nevoja për zbutje atje ku do të ketë ndikime negative të një grupi mbi grupin tjetër, dhe çfarë veprime mund të ndërmerren të reduktohet ndikimi ose të krijohet një politikë më e balancuar gjinore?
Hapi 4: Komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> ■ Cilat porosi duhet të komunikohen? ■ Si do të arrijë porosia grupet e ndryshme të femrave dhe meshkujve? ■ A thua janë të nevojshme qasje të veçanta? ■ Si reflekton politika në përbetimin e qeverisë për barazi dhe a thua duhet të përfshihet porosi e saj specifike lidhur me barazinë? ■ A thua janë përdorur gjuha e ndjeshme gjinore, simbolet dhe shembujt në materialet e komunikimit të politikës? ■ Si do të komunikoni me femrat dhe meshkujt të cilët flasin gjuhë tjetër ose që janë analfabet?
Hapi 5: Implementimi	<ul style="list-style-type: none"> ■ A thua politikat ose shërbimet do të ndjehen ose kenë qasje ndryshe nga femrat dhe meshkujt, dhe a thua dallimi do të ndikohet nga përkatësia etnike, handicapi, moshë, religjioni ose orientimi seksual? Çfarë përgatitje ekzistojnë të keni qasje te ata të cilët mund të përjashtohen? ■ A thua munden shërbimet të livroheshin së bashku – gjegjësisht a thua departamentet e tjera qeveritare, organizatat lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare mund të ndihmojnë në livrimin e shërbimeve për target femrat dhe meshkujt? ■ A thua ata që implementojnë/livrojnë politikën ose shërbimet përfaqësojnë llojshmërinë e komunitetit që shërbehet A janë femrat barabartë të përfshira në implementim? ■ A thua janë ndarë resurse specifike dhe të mjaftueshme (financiare dhe njerëzore) për të mundësuar arritjen e qëllimeve të barazisë gjinore? ■ A janë implementuesit përgjegjës në aspektin gjinor dhe të vetëdijshëm për çështjet specifike gjinore?
Hapi 6: Monitorimi	<ul style="list-style-type: none"> ■ A thua përfituesit femëror dhe mashkullor marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin e monitorimit? ■ A thua kërkesat e monitorimit përfshijnë masa për barazi gjinore, matje të kënaqësisë së konsumatorëve dhe a thua shpalosen në atë aspekt që politika me sukses ti drejtohet nevojave të ndryshme të femrave dhe meshkujve? ■ Si munden organizatat e jashtme që përfaqësojnë grupet e ndryshme në komunitet të ndihmojnë në monitorimin e rezultateve të politikës? ■ A janë masat në vend të duhur që të iniciojnë hulumtime ose të ndryshojnë politikat nëse nuk livrojnë as qëllimet e dëshiruara të barazisë të definuar në rezultatet e projektit ose barazi për mundësitë të femrave dhe meshkujve?
Hapi 7: Vlerësimi	<ul style="list-style-type: none"> ■ A thua politika promovon dhe livron barazi të mundësive për femrat dhe meshkujt? A thua janë përmbushur qëllimet për femrat dhe meshkujt? ■ ✕A thua një grup morri përfitime më të mëdha se sa të tjerët – nëse po, si do ti drejtoheni mos-baraspeshës? A thua hyrjet u vendosën në mënyrë të duhur? ■ ✕Cili është ndikimi i përgjithshëm në statusin e cilësisë së jetës për femrat dhe meshkujt? ■ ✕A thua procesi përfshiu femrat dhe meshkujt? A thua kërkonte dhe vlerësonte mendimet e tyre në mënyrë të barabartë? ■ ✕A ekziston nevoja për grumbullimin e të dhënave shtesë dhe a thua targetet dhe treguesit nevojitet të ndryshohen nga aspekti i eksperiencës? ■ Cilat mësimë ekzistojnë për përmirësimin e politikave dhe shërbimeve, kush duhet të informohet dhe si duhet të paraqitet informata?

Shembulli 12 është listë e sferave që do të ishin relevante për mbulim kur vlerësojmë nevojat e sigurisë.

Analiza e buxhetit gjinor

Analiza e buxhetit mund të jetë një instrument i fuqishëm për mbikëqyrjen e institucioneve për përdorim në fazat e përpilimit dhe M&E të politikave të sektorit të sigurisë. Edhe pse është shpesh Parlamenti ai i cili udhëheq në kërkimin për analizat gjinore të buxhetit si pjesë e hyrjes në debate për atë se si do të shpenzohen të ardhurat shtetërore, CSO mundet gjithashtu të iniciojë analiza gjinore të buxhetit. Analizat gjinore të buxhetit mund të përcaktojnë se a thua janë shpërndarë fonde përkatëse për t'ju drejtuar çështjes së nevojave të ndryshme të sigurisë dhe drejtësisë dhe prioritetëve të meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve.

Pyetjet kresore që duhet parashtruar si pjesë e analizës gjinore të buxhetit të politikave të sigurisë:

1. Deri ku vendosjet e përgjithshme të parave kanë mundësuar barazi për sigurinë e meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve?
2. Deri ku buxheti specifikonte fondet për meshkujve, femrave, vajzave dhe djemve? (Për shembull, nëpërmjet të dedikimit të fondeve për marrjen target meshkujt në programin për parandalimin e dhunës familjare, ose mbështetje të femrave viktimat të trafikimit). A thua ishte vendosja e resurseve adekuate për implementim efektiv?
3. Deri ku buxheti specifikonte aktivitetet e lidhura me gjininë, hyrjet dhe koston? (Për shembull, nëpërmjet të dedikimit të fondeve për trajnim gjinor ose post si pikë kontakti për gjininë).
4. Deri ku specialistët/këshilltarët gjinor dhe organizatat e grave marrin pjesë në hapat e ndryshme të ciklit të buxhetit (p.sh. përpilimin, revidimin)?⁵⁴

Në baza të analizës së buxhetit, organet mbikëqyrëse mundet të japin informata për diskutim duke:

- Gjeneruar debate në mediumet.
- Duke publikuar dokumentet për kornizën e buxhetit.
- Duke vënë në dispozicion raportet për anëtarët e Parlamentit, ne veçanti ata në komisionet relevante të mbrojtjes, sigurisë dhe buxhetit.
- Duke ju dhënë parlamentarëve ndihmën teknike në analizimin dhe propozimin e shpërndarjes së mjeteve në sektorin e sigurisë. Kjo mundet të bëhet nëpërmjet të trajnimit ose aktiviteteve të lobimit të CSO.

5 Integrimi i gjinisë në politikat kombëtare të sigurisë në kontekst specifik

Ky seksion përshkruan disa prej mënyrave kryesore në të cilat gjinia mundet të integrohet në sjelljen e politikave të sigurisë kombëtare në shtetet post konfliktit, shtetet në zhvillim, në tranzicion dhe në shtetet e zhvilluara. Në të njëjtën kohë duhet të theksohet se nuk ekziston ndonjë model i cili është “një madhësi ju përgjigjet të gjithave” përkrijimin e politikave të sigurisë në kontekstet e ndryshme. Rrethanat e secilit shtet ndikojnë mbi kontekstin e tyre të sigurisë dhe proceset e sjelljes së politikave dhe nëse konteksti specifik politik, ekonomik dhe social nuk merret në konsiderim, politikat kanë shumë gjasa që të dështojnë (shiko Tabela 1).

5.1 Shtetet post-konfliktit

Në shumë shtete të prekura nga konflikti, fillimisht aktorët dhe institucionet të cilat duhet detyrimisht të përpilojnë dhe implementojnë politikat e sigurisë ndoshta nuk ekzistojnë. Sektori i sigurisë, forcat e armatosura në veçanti, shpesh kanë fuqi edhe mbi ligjin. Në vend që ti shërbejnë popullatës, aktorët e sektorit të sigurisë shumë shpesh janë të shfrytëzuar nga shteti që të shtypin çdo lloj forme të kundërshtimit dhe të risin militarizimin në shoqëri. Në disa vende, ushtarakët e fuqishëm kanë destabilizuar qeveritë qytetare. Në vende të tjera, sektori i sigurisë pranon një sasi joproporcionale të buxhetit kombëtar, që në fakt, ri-drejtojnë resurset prej zhvillimit në shpenzime ushtarake. Prandaj, është shumë e mundshme që në rrethanat të tilla rezistenca për reforma të jetë e fortë.

Në rindërtimin dhe transformimin e cilit do shtet që ka dalë nga lufta, RSS është një prioritet kryesor. Politikat e sigurisë do formojë një bazë të rëndësishme për strukturimin e këtij procesi. Për shembull, strategjitë kombëtare të sigurisë kanë formuar bazat – dhe vazhdojnë të bëjnë atë gjë edhe më tutje – në procesin e RSS në Sierra Leone. Përderisa një kohë e konsiderueshme dhe resurse janë zakonisht të nevojshme për të krijuar rrënjët, konteksti post-konfliktit ofron një mundësi për të ri-negociuar rolin dhe përgjegjësinë të shtetit dhe aktorëve joqeveritar të ngjashëm nëpër procesin e sjelljes së politikës.

Shembulli 12 Gjinia dhe teknikat e vlerësimit socio-ekonomik për politikat e sigurisë ⁵³	
Statistikat e pagrum-bulluara	Grumbullimi dhe analiza e të dhënave sipas kategorive (p.sh. gjinia dhe përkatësia etnike), me qëllim që të identifikojë zbrazëtitrat dhe shabllonet e sigurisë/socio-ekonomike të diskriminimit në një situatë të dhënë, siç është ajo midis femrave dhe meshkujve, ose midis femrave dhe meshkujve të përkatësisë së ndryshme etnike. Këta të dhëna na ndihmojnë të identifikojmë nevojat e sigurisë dhe prioritetet të grupeve të ndryshme në shoqëri, dhe ndihmon të formohet fokusi i politikave të sigurisë.
Vlerësimi i nevojave praktike	Matja e nevojave të menjëhershme të sigurisë e femrave dhe e meshkujve ashtu si rriten është rezultat i statusit të tyre në shoqëri.
Vlerësimi i nevojave strategjike	Vlerësimi i nevojave më të gjera të femrave dhe meshkujve, përfshirë këtu rrezikun e pasigurisë të lidhur me legjislacionin joadekuat ose mungesës së mundësive për punësim.

Tabela 1 Kontekstualizimi i sjelljes së politikave të sigurisë në RSS ⁵⁵				
	Shtete në zhvillim	Shtetet në tranzicion	Shtetet post-konflikti	Shtetet e zhvilluara
Kriteret kyçe	Niveli i zhvillimit ekonomik.	Natyra e sistemit politik.	Situata specifike e sigurisë	Dëshira politike.
Sfidat kryesore	Defiçiti i zhvillimit. Shpenzime të tepërta ushtarake; keq të menaxhuara/sektori qeveritar i sigurisë dërgon kah dispozitat joefektive të sigurisë, prandaj i divertojnë resurset e pakëta për zhvillimin.	Defiçiti i zhvillimit. Kompleks i tejngarkuar, me resurse të tepërta të industrisë ushtarake; shtet i fortë, por institucione të dobëta të shoqërisë civile; mungesë në implementimin e politikave për RSS.	Defiçiti i sigurisë dhe demokracisë. Institucionet qeveritare dhe të shoqërisë civile janë në kolaps; popullata e zhvendosur; privatizimi i sigurisë; ekzistojnë mundësi prej rezistencës me armë; begati e armëve të vogla dhe minave kundër njerëzore.	Dëshira politike. Në disa kohë resurse të tepruara, tejngarkuara ushtarake.
Mundësitë për zbatimin e RSS	Të kombinuar (varësisht nga përbesimi politik për reformat, fuqia e institucioneve shtetërore, roli dhe gjendja e forcave të sigurisë, siguria rajonale e mjedist, qasja e donatorëve për RSS, etj.).	Mjaft të mira (institucione të forta shtetërore, forca profesionale të sigurisë, procese më të gjera të demokracizimit), madje edhe më mirë nëse ekzistojnë stimulime të jashtme (p.sh. bashkëngjitja në EU dhe NATO).	Mjaft të dobëta (institucione shtetërore të dobëta dhe të diskutueshme, privatizimi i sigurisë, varësi për mbështetjen e paqes/intervenim nga forcat).	Kombinuar (të varura nga përbesimi politik për reforma, dhe fuqia relative e kompleksit të industrisë ushtarake); institucione të forta shtetërore dhe komunitetit të CSO, por me një distancë të madhe mes tyre.
Procesi i reformave të përgjithshme	Tranzicion nga ekonomia e nënzhvilluar në ekonomi të zhvilluar.	Tranzicion nga sistemi autoritativ në demokratik.	Tranzicion nga konflikti i dhunës në paqe.	Përgjigja ndaj ndryshimit në mjedisin e sigurisë.
Natyra e involvimit të jashtëm	Zhvillimi i ndihmës i shoqëruar më kushtëzimin politik.	Qasje deri te institucionet multilaterale si stimulim për reformat.	Intervenim ushtarake/okupim; kryesisht operacione mbështetëse paqesorë të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara.	Zakonisht asnjë.
Aktorët kryesor të jashtëm	Aktorët e zhvillimit/financiar: donatorë multilateral (p.sh. OECD, UNDP, Banka Botërore); donatorët bilateral; aktorët joqeveritar.	Aktorët e sigurisë: ndërkombëtar (p.sh. EU, NATO, OSBE); qeveritë; aktorët joqeveritar (p.sh. OJQ ndërkombëtare, kompanitë ushtarake private).	Aktorët e sigurisë: forcat e intervenimit; forcat paqeruajtëse nën mbështetjen ndërkombëtare, aktorët joqeveritar (p.sh. kompanitë ushtarake private).	Zakonisht asnjë.

Sfidat për integrimin e çështjeve të gjinisë përfshijnë:

- Institucionet shtetërore dhe infrastruktura mund të kenë shembur ose të rëndë të dobësuar. Kështu pra mund të ketë kapacitet të kufizuar dhe burime të kufizuara të financave për të kryer procese konsultimi me bazë të gjerë, në dëm të përfshirjes së perspektivave të gjinisë në bërjen e politikës.
- Në përgjithësi nivelet e ulta të edukimit dhe mungesa e ekspertizës teknike janë pengesa për angazhimin public në proceset e bërjes së politikës, duke ndikuar tek femrat dhe grupe të caktuara etnike në veçanti.
- Institucionet ekzekutive dhe të sigurisë shpesh e shohin CSO si kundërshtar politik, dhe prandaj nuk janë të gatshëm të punojnë me ata, duke krijuar kështu pengesa për përfshirjen e prespektivave nga grupet e gruas, për shembull.
- Mund të ketë rezistencë në mes të prsonelit në institucionet e sektorit të sigurisë të cilat janë të rindërtuara, në ekzekutivën, dhe në mes të politikanëve në përgjithësi që të fokusohen në gjininë tek bërja e politikës kur ka mungesë të burimeve themelore dhe

percepacion se më tepër çështje shtypëse kanë nevojë të adresohen

- Kur punohet në shtetet shumë të varfura, është e domosdoshme që të sigurohet se iniciativat gjinore të cilat janë të mandatuara në legjislativën dhe politikën janë të qëndrueshme dhe financiarisht kanë kuptim.
- Legjislacioni dhe politikat shpesh nuk janë të zbatuara kur janë të zhvilluara (në veçanti nëse drejtohen nga aktor të jashtëm).

Këshilla/rekomandime për integrimin e gjinisë bërjen e politikës së sigurisë në shtetet pas konfliktit:

- **Marrëveshjet e paqes:** Kur RSS përmendet në marrëveshje të paqes referencë e qartë duhet të bëhet për qëllimin e hartimit të NSP I cili është përgjegjës në aspektin gjinor.
- **Dialog kombëtar:** Në kontekst të post-konfliktit ku vizioni I unifikuar I sigurisë që mund të formon bazat e NSP mungon, do të jetë e dobishme të fillohet një dialog kombëtar gjithëpërfshirës për sigurinë i cili përfshin një fokus në çështjet gjinore.

- **Konsultimet rurale:** Ndarja rurale – urbane në shtetet post-konflikti është shpesh e rëndësishme, dhe involvimi dhe nevojat e meshkujve dhe femrave jashtë kryeqytetit kërkojnë vëmendje të veçantë.
- **Angazhimi:** Mbështetja e donatorëve për zhvillimin e politikave të përfshirjes së sigurisë është kritike për shkak të mungesës së zakonshme të burimeve në kontekstet post-konflikti. Duke zhvilluar dhe publikuar politika të sigurisë të përgjegjshme ndaj gjinisë do të ndihmon qeverinë në pushtet për të indikuar angazhim politik që t'i adresohet çështjeve të sigurisë dhe drejtësisë në përcaktimet post-konflikti.
- **Pronësia lokale:** Derisa pronësia lokale është bërë frazë e përdorur shpesh, prap se prap barazon legjitimitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të politikave të cilat janë zhvilluar. NSP sensitive e gjinisë është mundshme vetëm nëse është e formuar, drejtuar dhe e implementuar nga aktorët lokal, burra dhe gra.
- **Pranimi i GBV në bërjen e politikës:** Në shumë konflikte, GBV është e përdorur si strategji kundër civilëve, dhe pasojat e konfliktit shohin rritjen e shkallës së GBV, për shembull në formë të dhunës shtëpiake. Është thelbësore që meshkujt dhe femrat marrin pjesë në shkallë të barabartë në definimin e nevojave të tyre personale të sigurisë në proceset e politikës.
- **Gratë në pozitat zyrtare:** Zmadhojnë pjesëmarrjen e grave përmes mbrojtjes për emërimet në shkallë më të lartë ose vendosja e caqeve ose civateve strategjike. Gjithashtu forcojnë kapacitetin e femrave në pozitat zyrtare me qëllim që të rritet profile i tyre në çështjet e sigurisë dhe të sigurojnë se do të integrojnë çështjet e gjinisë dhe të takohen me grupet e shoqërisë civile.

5.2 Shtetet në tranzicion dhe zhvillim

Shtetet në tranzicion dhe zhvillim pushtojnë një gamë të gjerë të politikave të cilat dallohen në mënyrë të konsiderueshme në terme të kapaciteteve socio-ekonomike, teknike dhe të burimeve njerëzore. Derisa, për shembull, Bulgaria dhe Ukraina kanë zhvilluar NSP-të, kjo nuk është rast në shumë shtete në zhvillim. Po në të njëjtën kohë, shtetet në tranzicion dhe në zhvillim ndajnë disa sfida dhe çështje të ngjajshme në zhvillimin e politikave të sigurisë, përfshijnë:

- Mungesë e ekspertizës – dhe në raste tjera tërheqje politike dhe sociale – për të trajtuar në mënyrë adekuate me çështjet organizative, menaxheriale, të planifikimit dhe të poliitkës.
- Korupcioni
- Sfida e rregullimit të kompanive private të sigurimit.

Shtetet në tranzicion

Во некои транзициски демократии, понекогаш наречене disa demokraci në tranzicion, ndonjëherë i referrohet shteteve post-autoritare, mund të jetë se kapacitetet teknike që ndërmarrin RSS janë të rëndësishme, dhe se prioriteti kryesor do të jetë të ndërtohen struktura qeverisëse të përgjegjshme, legjitime dhe transparente vis-à-vis ofrimin e sigurisë dhe drejtësisë. Sfidat mund të vahdojnë, siç është trashëgimia e regjimit autoritativ, kriminal dhe/ose të korruptuar, dhe segmente të papërgjegjshme të aparaturës së sigurimit. Ose mund të ketë opozitë të forta birkoratike ndaj ndërtimit të mbikqyrjes qeverisëse dhe parlamentare të aktorëve të sigurimit, dhe t'i lejohet CSO-së të luan rolin e mbikqyrësit. Në shumë shtete të Unionit Sovjetik të dikurshëm dhe Europës Lindore dhe Centrale, çështja e etnicitetit ka luajtur rol të rëndësishëm në institucionet e sigurisë. Një numër i madh i politikave mund pra të jenë ndëruara në mënyrë simultane; këto ndryshime me sa duket janë thelbësore.

Në kontekstin Euro-Atlantik, stimulët e anëtarësimit në EU dhe NATO luanë rol të veçantë në hapjen e sistemit politik ndaj kontrollit politik të jashtëm. NATO është mjaftë i fokusuar në mjedisin e jashtëm të sigurisë, përfshirë këtu forcat e armatosura dhe reformat në mbrojtje. Nga ana tjetër, EU fokusohet në aspekte të ndryshme të RSS së mbrendshme, përfshirë edhe policinë dhe menaxhimin me kufijtë, dhe ka luajtur rol kyq në zgjerimin e debatit për RSS.

Shtetet në zhvillim

Si dhe tek shtetet në tranzicion, ka sfida të rëndësishme në sistemet përkatëse politike të shteteve në zhvillim,

Shembulli 13 Grupet e grave në shtetet e brishta të post-konfliktit ⁵⁶

Në një raport të komisionuar nga OECD Rrjeti i Komitetit për Ndihmë të Zhvillimit në Bashkëpunimin në Konflikt, Paqe dhe Zhvillim, është sugjeruar se grupet e grave tregojnë fleksibilitet të dukshëm në përballimin me situatat e ndryshimit dhe të përkeqësimit. Në Nepal, ofruesit jozyrtar të drejtësisë, në të shumtën meshkuj, ishin të zhvendosur nga konflikti dhe në shumë raste të zëvendësuar me grupe femrash. Në rastet e Guatemaës dhe Somalisë, grata kanë qenë në ballë të lëvizjeve paqësore. Kjo në mënyrë të ngjajshme ka qenë rast në Mano River Union (Guinea, Liberi dhe Siera Leone) ku një rrjet sub-regjional i grave në mënyrë efektive çoi deri tek bisedimet trilaterale në mes të kryetarëve të të tre shteteve. Rrjeta gjithashtu ishte në gjendje të lobon në mënyrë të suksesshme për negociuesit e paqes që të sigurohet përfshimi i çështjeve të gruas në marrëveshjen paqësore Liberiane.

Në mënyrë paradoksale, mjediset e përkeqësuar mund të ofrojnë mundësi unike për donatorët – dhe aktorët shtetëror sado që të jenë të brishtë – që të forcohen të drejtat e gruas duke përkrahur pjesëmarrjen e tyre në institucionet jo-shtetërore të drejtësisë. Raporti vazhdon të sugjeron se përpjekjet duhet të bëhen për të inkujaruar arhivimin dhe regjistrimin e mosmarrëveshjeve të adresuara në sistemin juridik jo-shtetëror ashtu që gratë në këto kontekste paraqiten më të ndërgjegjshme sesa meshkujt në mbajtjen e arhivës. Shkurtime në afat të mesëm, kjo do të jetë hapi i parë vendimtar në krijimin e lidhjeve mes sistemeve shtetërore dhe jo-shtetërore.

Për vetë arsyen se grupet e femrave në fund marrin rolin kyq në dorëzimin e drejtësisë gjatë dhe menjëherë pas konfliktit, do të jetë vitale për të marrë pikëpamjet e tyre dhe eksperiencën në llogari kur/nëse zhvillohet plani i sigurisë kombëtare.

përfshirë trashëgiminë e sundimit ushtarak dhe autoritativ, dhe opozitë të forte birokratike në ndërtimin e mbikqyrjes qeveritare dhe parlamentare. Përveç kësaj, CSO rrallë janë të konsideruar si partnerë, por si grupe opozitare të shtetit.

Për shkak të rolit të veçantë të agjencioneve donatore në shumë shtete të zhvillimit, pronësia lokale e proceseve reformuese është e rëndësishme kyçe. Bërja e politikës e shtyrë nga agjencionet donatore mund të mbarojë me pengimin e pronësisë së procesit nga marrësit qeveria dhe popullata. Kjo është veçanërisht rasti kur marrja e ndihmës është e kushtëzuar në arritjen e disa standardeve të caktuara reformuese ose shpalljen e politikave që duhet të zbatohen nga një sërë institucionesh. Agjencionet donatore megjithatë kanë rol të rëndësishëm në këshillimin se si të sigurojnë pjesëmarrjen e proceseve të bërjes së politikës të të gjitha grupeve të prekura nga kjo politikë. Në këtë kontekst, gjinia mund të promovohet si komponentë kyçe në procesin e bërjes së politikës.

Në shumë shtete në zhvillim, si në kontekst post-konfliktor, aktorët jo-shtetas janë ofrues të rëndësishëm të sigurisë dhe drjetësisë, dhe ndërpriten me sistemet formale shtetërore. Kjo mund të përfshin gjykatat tradicionale, shërbimet paralegale dhe njësitet lokale të mbrojtjes. Bërja e politikës së sigurisë duhet të thekson se autoritetet janë të menaxhuara, si shërbimet janë të dorëzuara dhe çfarë është legjitimiteti i tyre në sytë e burrave dhe grave.

Sfidat për integrimin e çështjeve të gjinisë në shtetet e tranzicionit dhe zhvillimit përfshijnë:

- Në shtetet tranzicionale, elitat në pushtet shpesh janë ato të cilat ishin në pushtet gjatë sundimit autoritativ, dhe prandaj mund të ketë opozitë të rëndësishme për të ndryshuar.
- Roli legjitim i CSO për të marrur pjesë proceset e bërjes së politikës së sigurisë mund të kontestohen, gjë që mund të krijojë pengesa për përfshirjen e perspektivave të gjinisë, dhe dallimin mes nevojave të ndryshme të grupeve të ndryshme në shoqëri.
- Agjencionet donatore të cilat nuk marrin parasysh gjininë në këshillimin e tyre tek shtetet në zhvillim mund të shkakton padashur përforcim të mosrespektit për perspektivat e gjinisë në proceset e bërjes së politikës.

Këshilla/rekomandime për integrimin e gjinisë në bërjen e politikës së sigurisë në shtetet në tranzicion dhe në zhvillim:

Ndërtimi i kapaciteteve: Në shtetet e tranzicionit dhe zhvillimit, institucionet e shtetit mund të jenë në vend, mirëpo transformimi i tyre në institucione demokratike dhe të përgjegjshme është një ndërmarje e rëndë dhe afatgjatë. Kërkon angazhim nga ekzekutiva dhe në disa raste, përkrahje nga komuniteti ndërkombëtar. Ndërtimi i kapaciteteve sa i përket aspekteve të lidhura me gjininë duhet të merr pjesë në nivele të shumta:

- **Ekzekutivi:** Të sigurohet se zyrtarët e lartë siç është Krey i Shtetit dhe ministrant të jenë të vetëdijshëm për politikën dhe angazhimet ndërkombëtare dhe kombëtare në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtave të njeriut. Aktorët e

jashtëm që janë të besueshëm mund të ndihmojnë.

- **Parlamenti:** Komitetet parlamentare në shtetet e tranzicionit dhe të zhvillimit kanë mungesë të ekspertizës në teknikën e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes dhe buxhetet e ushtrisë, e jo faktin se si lidhen me çështjet e gjinisë.

- **Shoqëria civile:** Në shtetet e tranzicionit dhe zhvillimit kur establishmenti politik është i dobët dhe sektori i sigurisë është i forte, politikanët në ekzekutivë dhe parlament mund të mbështeten në mbështetjen e hapur ose të heshtur të shërbimeve të sigurisë. Prandaj ato mund të shmangin reformat rrënjësore për shkak të frikës së provokimit të grushtshtetit. Ndërtimi i kapaciteteve të CSO për të mbikqyrur veprime të aktorëve të sigurisë he sensitivitetin e tyre ndaj shqetësimeve gjinore mund të – në afat të shkurtë deri të mesëm – dëshmojnë mekanizmat më efikase të mbikqyrjes. Edhe në qoftë se CSO, si pjesë organeve të mbikqyrjes të sektorit të sigurisë, nuk janë mirë të aftësuara në çështjet teknike të lidhura me mbrojtjen dhe sigurinë, ata prapë se prapë mund të luajnë rol të rëndësishëm në lidhje me përfaqësimin e meshkujve dhe ferave të zakonshme.

5.3 Shtetet e zhvilluara

Gjithnjë e më shumë, shtetet e zhvilluara siç janë SHBA-të dhe UK(MB) i shohin kërcënimet më të para ndaj sigurisë së tyre kombëtare si pyetje të cilat janë joshqëruese nga mirëqenia dhe stabiliteti i shoqërisë, siç reflektohet në NSP-në e tyre dhe politikën tjera të sigurisë. Siguria kombëtare megjithatë vazhdon të sillet rreth shqetësimeve makro politike/të sigurisë. SHBA-të kanë definuar kërcënimet e tyre të sigurisë kombëtare si zhvillim dhe përhapje të armëve të shkatërrimit në masë, kërcënimin për paqen prej terrorizmit, përdorimi i raketave ndaj SHBA-të dhe fatkeqesitë natyrore. Në mënyrë të ngjajshme, shqetësimet kryesore të sigurisë kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar janë identifikuar gjerësisht si terrorizëm, spiunazh, ndikimi i shteteve të dobta në stabilitetin global dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë. Mund të jetë e vështirë të bëhet e dukshme dimensionet e gjinisë të shqetësimeve të sigurisë kombëtare në këtë nivel.

Në të njëjtën kohë, një qasje e zmadhuar e gjinisë në zhvillimin e prioritetëve të sigurisë kombëtare në shtetet e zhvilluara mund të zgjerojnë debatin për atë se çka është siguria kombëtare dhe më me rëndësi çfarë mekanizma të përgjigjes duhen që të vendosen. Ashtu siç është sot, meshkujt janë të mbi-përfaqësuar në polici, ushtri, rojet kufitare, gjyqë, qeveri dhe institucione të tjera të sektorit të sigurisë dhe organet e mbikqyrjes në shtetet e zhvilluara. Rritja e përfaqësimit të grave në institucionet të cilat ofrojnë siguri dhe/ose institucione të cilat qeverisin këto institucione potencialisht mund të implikojnë se për çfarë ofrimi i sigurisë kupton në shtetet e zhvilluara, dhe me këtë për proceset e bërjes së politikës së sigurimit.

Në mënyrë të ngjajshme, shtetet e zhvilluara, përfshirë SHBA-të dhe MB-në janë në ballë të dhënies së këshillave dhe ekspertizës teknike shteteve të cilat i nënshtrohen RSS, përfshirë këtu edhe NSP dhe proceset e politikës së sigurisë. Rritja e ekspertizës së gjinisë mbrenda ekipëve donatore të RSS mund të zmadhon reagimin gjinor të mbështetjes dhe këshillimit tek formulimi i politikës së sigurisë.

Sfidat për integrimin e çështjeve të gjinisë përfshijnë:

- Tendenca për t'u fokusuar në kërcënimet e jashtme dhe makro politike ndaj shtetit është shpesh mbajtur në kurriz të kërcënimeve të mbrendshme të sigurisë, të cilat ndikojnë në mënyrë të ndryshme tek grupe të ndryshme në shoqëri.
- Neverisja për të përfshirë në mënyrë aktive perspektivat e gjinisë ku ekzekutiva – dhe popullata e përgjithshme – konsideron se barazia gjinore tashmë është arritur

Këshilla/rekomandime për integrimin e gjinisë në bërjen e politikës së sigurisë në shtetet e zhvilluara:

- Zgjerim i debatit se çfarë është siguria kombëtare: hap hapësirë për pjesëmarrjen publike në definimin e nevojave të sigurisë kombëtare. Kjo është çështje për ekzekutivën për të konsideruar dhe organet e mbikqyrjes të angazhohen për të.
- Debata politike përfshirëse: mjetet mire të funksionuara teknologjike dhe nivelet e larta të edukimit sigurojnë se një segment i gjërë i shoqërisë mund të merr pjesë në debata për sigurinë dhe mbrojtjen. Si rrjedhim, hapësirë për gjinitë mund të sigurohet, e që kërkon gatishmërinë në pjesën e ekzekutivës dhe parlamentit, dhe kampanjat e mbrotjes nga CSO.
- Zhivllimet politike përfshirëse: shtetet e zhvilluara janë zakonisht të karakterizuara nga shoqëri të gjalla civile, përfshirë këtu edhe aktivitetet e analistëve, akademikëve dhe Organizatave joqeveritare. Tradicionalisht, megjithatë, bërja e politikës së qeverisë qendrore vetëm në mënyrë selective ka kërkuar këshilla nga "pale të jashtme". Seancat publike mund të bëjnë procesin e bërjes së politikës të përfshirë, dhe të bëjnë një pike hyrëse për çështjet e gjinisë.
- Gjinia si komponentë kryesore e ndihmës RSS: kapaciteti i mbushur në shtetet e zhvilluara për të ndihmuar qeveri të tjera në RSS dhe hartimit të përshtatshëm të politikave duhet të përfshin ekspert dhe këshilltar të gjinisë.

6 Rekomandime kryesore

1. nicion **dialog konsultativ dhe pjesëmarrës kombëtar** për çështjet e sigurisë kur politikave të sigurisë në nivel kombëtar po modifikohen ose përpilohen.
2. Të zbatohet **vlerësim në aspektin gjinor të nevojave kombëtare dhe në nivel lokal të sigurisë**, përfshirë edhe nevojat dhe resurset e ndryshme të sigurisë për meshkujt, femrat, vajzat dhe djemtë.
3. Adoptojë një **gasje e gjithëmbarshme e sigurisë kombëtare** brenda politikave të sigurisë, përfshirë edhe kërcënimet e jashtme edhe të brendshme, siç është GBV.
4. Të ndërtojë **kapacitetet gjinore dhe përbetimin e vendim-marrësve të politikave të sigurisë** Brenda ekzekutivit, ministrive, parlamentit dhe partive politike nëpërmjet të trajnimit gjinor, mentorimit, shpërndarjes së informatave dhe lobimit.
5. Të sigurojë **emërime të barabarta dhe promovime të meshkujve dhe femrave** për organet që sjellin politikave të sigurisë siç janë Këshillat Kombëtare të Sigurisë, si edhe niveli i lartë ministror dhe pozitave në institucionet e sektorit të sigurisë.
6. Të përfshijnë **ekspertizën gjinore** organet që sjellin politikave të sigurisë, për shembull nëpërmjet të përfaqësimit e komisioneve drejtuese parlamentare ose ministrive përgjegjëse për femrat dhe çështjet gjinore.
7. Të themelojë **organe pjesëmarrëse të sigurisë lokale** për të mundësuar informata të sjelljes së politikave në nivel kombëtar dhe të sigurojë implementimin në nivel lokal të politikave kombëtare të sigurisë nëpërmjet të revizioneve të sigurisë, planeve dhe aktiviteteve të koordinuara.
8. Të shpërndajë **resurse të mjaftueshme**, si pjesë e implementimit të politikave kombëtare për sigurinë, që në mënyrë efektive të parandalojë, ti përgjigjet dhe të dënojë josisuritë specifike me të cilat ballafaqohen meshkujt, femrat, vajzat dhe djemtë dhe të financojnë iniciativat specifike gjinore siç është trajnimi gjinor.
9. Të zbatohet **monitorim dhe vlerësim të bazuar në gjininë** të politikave kombëtare të sigurisë, përfshirë nëpërmjet të vlerësimit të ndikimit të gjinisë të politikës së sigurisë dhe analizës gjinore të buxhetit.
10. Themelojnë **mekanizma për pjesëmarrje të organizatave të shoqërisë civile**, përfshirë organizatat e grave, në zbatimin e dëgjimeve të tilla parlamentare dhe konsultimeve nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë.
11. Ndërtojë **kapacitet të organizatave të shoqërisë qytetare** që në mënyrë efektive të marrin pjesë në proceset e sjelljes së politikave të sigurisë, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve teknike të organizatave të grave.
12. Të zhvillojë **rrjetat e organizatave të shoqërisë qytetare**, përfshirë organizatat e grave, që punojnë në çështjet lidhur me sigurinë për të siguruar informatat e tyre strategjike në sjelljen e politikave kombëtare të sigurisë.

7 Resurse shtesë

Shembuj të politikave kombëtare të sigurisë

National Security Policy for **Jamaica** – Towards a Secure and Prosperous Nation.
http://www.cabinet.gov.jm/docs/pdf/NSS_DOCS/nspanet.pdf

South Africa's White Paper on National Defence for the Republic of South Africa – Defence in a Democracy.
<http://www.info.gov.za/whitepapers/1995/defence.htm>

South Africa's White Paper on Safety and Security.
<http://www.info.gov.za/whitepapers/1998/safety.htm>

Romania's National Security Strategy.
<http://merln.ndu.edu/whitepapers/RomaniaNationalSecurity.pdf>

Doctrine of the Armed Forces of the **Slovak Republic**.
<http://www.arabparliaments.org/publications/legisla-ture/2007/montreux/slovak-e.pdf>

Ireland's White Paper on Defence.
<http://www.statehouse-sl.org/policies/defence-white-paper.htm>

Sierra Leone's Defence White Paper.
<http://www.whitehouse.gov/nsc/nss.pdf>

The **Uganda** Defence Review – Learning from Experience. <http://www.ssrnetwork.net/documents/Publications/UDR/Uganda%20Defence%20Review%20-%20Learning%20From%20Experience.pdf>

The **US** National Security Strategy.
<http://www.whitehouse.gov/nsc/nss/2006/>

Udhëzime praktike dhe doracakë

Organisation for Economic Co-operation and Development, **OECD DAC Handbook on Security System Reform: supporting security and justice**, Paris: OECD DAC, 2007.
<http://www.oecd.org/dataoecd/43/25/38406485.pdf>

Luethold, A., **Developing A National Security Policy**, Presentation, 2007.
<http://www.arabparliaments.org/publications/legisla-ture/2007/montreux/leuthold-e.pdf>

South Africa's Department of Community Safety, **Community Police Forum Toolkit**, 2003.
http://www.capecgateway.gov.za/eng/pubs/public_info/C/32970

Valasek, K. with Nelson, K., **Securing Equality, Engendering Peace: A Guide to Policy and Planning on Women, Peace and Security**, UN-INSTRAW: Santo Domingo, 2006.

Online artikuj dhe raporte

Bearne, S. ed al, **National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform**, The RAND Corporation, 2005.
http://www.rand.org/pubs/technical_reports/TR289/

DCAF Backgrounder: **National Security Policy**, 2005.
<http://www.dcaf.ch/publications/kms/details.cfm?lng=en&id=18417&nav1=4>

Bearne, S. ed al, **National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform**, DfID, 2005.
<http://www.dfid.gov.uk/Pubs/files/security-decision-making.pdf>

Shënime fundore

1. For ease of reference within the tool, the term 'security policies' refers to national-level security policies.
2. IPU and DCAF, Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices, (IPU and DCAF: Geneva), 2003, p. 27.
3. Adapted from Luethold, A., 'Developing a National Security Policy', Workshop on the Role of the Parliament in the Development of a National Security Policy in the Arab Region (Presentation, Montreux) 2007. <http://www.arabparliaments.org/publications/legislature/2007/montreux/leutholde.pdf>
4. DCAF Backgrounder, 'Security Sector Governance and Reform' (DCAF: Geneva), Nov. 2005, p. 1.
5. Fluri, P.H. and Johnsson, A.B., 'Parliamentary Oversight of the Security Sector', Geneva, 2003, p. 26.
6. Organisation for Economic Co-operation and Development, OECD DAC Handbook on Security System Reform – Supporting Security and Justice, Paris, 2007, p. 92.
7. The US National Security Strategy. <http://www.whitehouse.gov/nsc/nss/2006/>
8. Shalamanov, V., 'Practices of Security Sector Reform in Europe – the Case of Bulgaria', The Challenges of Security Sector Reform in Macedonia, 6-7 Dec 2002.
9. Lithuania's National Security Strategy. <http://merln.ndu.edu/whitepapers/LithuaniaNationalSecurity-2002.doc>
10. Adapted from Luethold, A., 'Developing a National Security Policy', Workshop on the Role of the Parliament in the Development of a National Security Policy in the Arab Region (Presentation, Montreux) 2007. <http://www.arabparliaments.org/publications/legislature/2007/montreux/leutholde.pdf>
11. Lithuania's Defence White Paper. <http://merln.ndu.edu/whitepapers/Lithuania-2006.pdf>
12. Bosnia-Herzegovina's Defence White Paper. http://merln.ndu.edu/whitepapers/Bosnia_English-2005.pdf
13. UN Economic and Social Council. Report of the Secretary-General, Coordination of the Policies and Activities of the Specialized Agencies and Other Bodies of the United Nations System: mainstreaming the gender perspective into all policies and programs in the United Nations system, 12 June 1997.
14. 'Priorities for Liberia's Reconstruction Process', Woodrow Wilson International Center for Scholars, 14 Feb. 2007. http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?topic_id=1411&fuseaction=topics.event_summary&event_id=224140
15. Danish International Development Agency, 'Sikkerhed, vækst – udvikling' (DANIDA: Copenhagen), Aug. 2004, p. 17.
16. Anderlini, S.N. and Conaway, C.P., Negotiating the Transition to Democracy and Reforming the Security Sector: The Vital contributions of South African Women, (Women Waging Peace: Washington DC), Aug. 2004.
17. Anderlini and Conaway. vi.
18. UNIFEM, Not a Minute More: Ending Violence Against Women (UNIFEM: New York), 2003, p. 6.
19. Centers for Disease Control and Prevention, 'Intimate Partner Violence: Overview'. <http://www.cdc.gov/ncipc/factsheets/ipvfacts.htm>
20. National Security Strategy for Jamaica – Towards a Secure and Prosperous Nation. http://www.jdfmil.org/NSS_SDR/NSS_DOC.pdf
21. 'Domestic Violence – A National Report', March 2005. <http://www.crimereduction.gov.uk/domesticviolence/domesticviolence51.pdf>
22. Barnes, K., Albrecht, P. and Olson, M., 'Addressing Gender-Based Violence in Sierra Leone: Mapping Challenges, Responses and Future Entry Points', (International Alert: London), 2006.
23. Struckman-Johnson, C. & Struckman-Johnson, D., 'Sexual Coercion Rates in Seven Midwestern Prisons for Men', The Prison Journal 379 (2000). <http://www.spr.org/pdf/struckman.pdf>
24. Carpenter, R.C., 'Recognizing Gender-Based Violence Against Civilian Men and Boys in Conflict Situations', Security Dialogue. Vol. 37(1) (2006), p. 87.
25. Securing an Open Society: Canada's National Security Policy, April 2004. http://www.pco-bcp.gc.ca/docs/InformationResources/Publications/NatSecumat/natsecumat_e.pdf
26. National Committee for the Advancement of Women in Viet Nam, 'Gender in Public Policy', Gender Mainstreaming Guidelines in the National Policy Formulation and Implementation. Towards Gender Equality in Viet Nam through Gender-Responsive National Policy and Planning, Hanoi, 2004, VIE 01-015-01 Project, p.28.
27. Bearne, S. ed., 'National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform', UK, June 2005. <http://www2.dfid.gov.uk/pubs/files/securitydecision-making.pdf>
28. The operational implications of crisis management are not fully explained, but the concept was introduced as a replacement in the NSC bill, which proposed 'matters relating to democracy, governance and inter-provincial harmony'.
29. Inter-Parliamentary Union, 'Women in Politics: 2005'. http://www.ipu.org/pdf/publications/wmnmmap05_en.pdf
30. Nathan, L., Local Ownership of Security Sector Reform: A Guide for Donors, London, Jan. 2007, p. 31.
31. Sierra Leone's White Paper on Defence, paragraph 1018.
32. Ukraine's National Security Strategy, paragraph 3.10; Romania's National Security Strategy, paragraph 3.2. <http://merln.ndu.edu/whitepapers/RomaniaNationalSecurity.pdf>
33. Romania's National Security Strategy, paragraph 5.3.
34. Ireland's White Paper on Defence. <http://www.statehousesl.org/policies/defence-white-paper.html> Sierra Leone's White Paper on Defence. <http://www.whitehouse.gov/nsc/nss.pdf> National Security Strategy of Ukraine (unofficial translation). <http://www.mfa.gov.ua/usa/en/publication/content/8387.htm> National Security Concept of Georgia. http://www.mfa.gov.ge/?sec_id=23&lang_id=ENG; National Security Strategy for Jamaica – Towards a Secure and Prosperous Nation. http://www.jdfmil.org/NSS_SDR/NSS_DOC.pdf
35. South Africa's White Paper on Intelligence, South Africa 1995, paragraph 5.6. <http://www.info.gov.za/whitepapers/1995/intelligence.htm>
36. South Africa's White Paper on National Defence for the Republic of South Africa – Defence in a Democracy, Chapter 6, Paragraph 36-37 (South Africa 1996). <http://www.info.gov.za/whitepapers/1995/defence.htm>
37. South Africa's White Paper on Safety and Security (South Africa 1998). <http://www.info.gov.za/whitepapers/1998/safety.htm>
38. 'Security Sector Reform - Potentials and Challenges for Conflict Transformation', Berghof Handbook Dialogue Series, No. 2, p. 58. http://www.berghofhandbook.net/uploads/download/dialogue2_RSS_complete.pdf
39. Fluri and Johnsson.
40. Nathan, p.38.
41. Inter-Parliamentary Union, Women in National Parliaments, IPU, 31 Oct. 2006.
42. Anderlini and Conaway.
43. 'Ready to Govern – ANC Policy Guidelines for a Democratic South Africa' adopted at the National Conference, 28-31 May 1992. <http://www.anc.org.za/ancdocs/history/readyto.html>
44. Department of Community Safety Provincial Administration Western Cape, Community Police Forum Toolkit, 2003. http://www.capecgateway.gov.za/Text/2003/12/community_police_forum_toolkit_pp41to80.pdf
45. Open Society, Justice Initiative. http://www.justiceinitiative.org/activities/ncjr/police/peru_cdsc
46. Organisation for Economic Co-operation and Development, p. 55.
47. Dfid, p.30.
48. Organisation for Economic Co-operation and Development, p.119.
49. <http://www.peacewomen.org/un/ngo/back.html>
50. National Security Policy for Jamaica – Towards a Secure and Prosperous Nation. http://www.cabinet.gov.jm/docs/pdf/NSS_DOCS/nspannet.pdf; National Security Strategy for Jamaica – Towards a Secure and Prosperous Nation, A Green Paper. Revised May 2006; and Stone, C. ed al, Supporting Security, Justice, and Development: Lessons for a New Era, June 2005.
51. Born, H., Fluri, P.H and Johnsson, A.B. Handbook on Parliamentary Oversight of the Security Sector, (DCAF: Geneva), 2003.
52. Valasek, K., 'Gender and Democratic Security Governance', Public Oversight of the Security Sector: A Handbook for CSO on Democratic Security Governance., Caparini, M., Cole, E. and Kinzelbach, K. eds. (Renesans: Bratislava for UNDP & DCAF), forthcoming July 2008.
53. Adaptuar nga Valasek, K. with Nelson, K., Securing Equality, Engendering Peace: A Guide to Policy and Planning on Women, Peace and Security (UN 1325) (INSTRAW: Santo Domingo), 2006, p.24.
54. Adaptuar nga: Gender, Women and DDR: Gender-responsive Monitoring and Evaluation Indicators. http://www.unddr.org/tool_docs/Genderresponsive%20Monitoring%20and%20Evaluation%20Indicators.pdf
55. Adaptuar nga Bryden, A. and Hänggi, H., 'Reforming and Reconstructing the Security Sector', (Geneva: DCAF) 2005, p.30. http://www.dcaf.ch/_docs/Yearbook2005/bm_sgpc_ch02.pdf
56. DAC CPDC, Enhancing the Delivery of Justice and Security in Fragile States, July 2006, p. 42.

